



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.126 Prot.

Tiranë, më 23 .01. 2024

V E N D I M

Nr.25 , Datë 23.01. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.144 Regj., datë 18.07.2023, paraqitur nga znj. Sh.B (B), përfaqësuar nga Av. E.D, me Licensë Nr. 4033, kundër Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (*në vijim TKOBAP*), me pretendimin se është diskriminuar në fushën e punësimit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja znj. Sh.B (B) parashtroi se, ka filluar punë si soprano dramatike në institucionin TKOBAP në vitin 2000 (*vendi i punës është i fituar me konkurs*) dhe ka vazhduar të jetë në këtë pozicion deri në datën 04.04.2023, ku sipas shkresës nr.343/2 prot., datë 04.04.2023, Urdhër nr.40, i ndërpriten marrëdhëniet e punës në mënyrë të menjëhershme. Me një përvojë 23 vjeçare në skenën e TKOBAT, me gati 20 role të realizuara, sot gjendet e papunë, për shkak të këtij urdhëri absurd, i marrë në shkelje të Rregullores së Brendshme të institucionit dhe Kodit të Punës. Gjatë këtyre viteve ankuesja është vlerësuar me çmimin “KULT”, si artistia më e mirë lirike për vitin 2010, si dhe ka marrë dy herë me çmime, një të parë dhe një të tretë.

Duke marrë shkas nga Urdhri nr.40, datë 04.04.2023, ku Drejtori i Përgjithshëm i institucionit të TKOBAP, ka urdhëruar ndërprerjen e menjëhershme të punës, ankuesja paraqet këtë ankim bazuar në ligjin nr.10221, datë 04.02.2012 “*Për mbrojtjen nga diskriminim*”, i ndryshuar, neni 3, ku

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

aftësia e saj profesionale nëpërkëmbet, për shkak të mllefrit të brendshëm që titullarja ka patur drejtpërdrejt me ankuesen, që në kohën që mbante pozicionin e drejtoreshës artistike, në këtë institucion. Lidhur me këtë marrëdhënie të ish- drejtoreshës artistike znj. V. me ankuesen, kjo e fundit është ankuar disa herë drejtpërdrejtë tek ish Drejtori i Përgjithshëm znj. Z.Ç .

Për të sjellë në vëmendje, marrëdhëniet e znj. V. (Drejtoreshë artistike) me ankuesen kthehemi pas në kohë në vitin 2019, kur znj.B (B) është ankuar disa herë në mënyrë të vazhdueshme tek drejtoresha e institucionit znj. Z.Ç , përkundrejt sjelljes së znj. A.V. , duke i vënë në dukje njëanshmërinë e saj në vlerësim, si dhe padrejtësitë që ajo ka bërë në mënyrë të përsëritur, për ta mënjanuar nga shafqjet e organizuara nga TKOBAP.

Sipas ankueses, një rast i tillë është audicioni i zhvilluar në datën 21.10.2019, ku në përbërje të komisionit ishte znj.V. në funksionin e kryetarit dhe 2 antare z. G. e znj. D. K (*shoqja e A. V*). Vlerësimi i bërë nga kryetari znj. V. (17 pikë) dhe një antare e komisionit znj. Kuraja (28 pikë) ishte tendencioz, duke i dhënë ankueses pikët më të ulta, me qëllim që ajo të mos merrte pjesë në shfaqje. Në këtë rast, krejt tjetër ka qenë vlerësimi i profesorit të kantos z. G., i cili e ka vlerësuar solisten me pikët maksimale (44 pikë). Në total ankuesja ka marrë 87 pikë falë vlerësimit “korrekt” të drejtoreshës artistike znj. V. . Pyetja që shtohet: *Si është e mundur që një profesor i kantos e vlerëson sopranon me 44 pikë, ndërsa kryetari i komisionit dhe antari tjetër që nuk është specialist në këtë zhaner, e vlerëson 17 dhe 28 pikë?* Pra, këtu ka diçka që nuk shkon! O profesori i kantos ka bërë vlerësim të “gabuar” dhe dy vlerësimet e tjera janë “ekzakte” dhe janë bërë me tendencë dashakeqësie të tepruar, ku dhe dalin zbuluar.

Referuar rastit të ndodhur në datën 21.09.2021 dhe 16.09.2021 në inagurimin e TKOBAP, që është dhe evenimenti më i rëndësishëm për çdo artist që punon dhe kontribon në këtë institucion dhe jo vetëm, por për të gjithë artistët që kanë dhënë në skenë për vite me radhë (që sot janë në pension apo jashtë vendit), ditën e fundit të përgatitjes për shfaqjen që do të zhvillohej, ankuesja e sheh veten jashtë këtij eventi, në 2 netët GALA, pa asnjë motiv të shkruar. Pa i thënë se je e aftë apo e paaftë për të dalë në skenë.

Për sjelljen në fjalë të drejtoreshës artistike znj. V. , ankuesja ka vënë në dijeni Sindikatën e Artistëve, dhe kërkon sqarime për përjashtimin e saj pa motiv nga GALA-ja. Nga A. e Sindikatës është kërkuar sqarim lidhur me këtë fakt, duke i drejtuar kërkesë znj. Z.Ç si drejtuese institucioni me nr.513 prot., datë 13.09.2021. Lidhur me këtë shqetësim, ankuesja i ka dërguar *e-mail* znj. V. , e cila në përgjigje të *e-mail* të dërguar nga ankuesja, shprehet se:

- 1- GALA-ja, nuk është saxho e një klase kanto, ku detyrimi i mësuesit është nxjerrja e çdo studenti pavarësisht ecurisë së tyre artistike, por një koncert me kritere të larta artistike.
- 2- Keni qënë pjesë me Mercedes dhe nuk deshët t’a interpretonit sepse ju e vlerësoni vet veten tuaj. Askush nuk mori masa as ekonomike e as artistike për refuzimin tuaj, por u vendos t’i kalohej parti një solisteje tjetër.

Bashkëlidhur *e-maili-it*, ka dërguar vlerësimin e bërë nga dirigjenti Edmond Doko, vlerësim të cilin znj. V. , e përdor si mjet të posaçëm presioni, që ankuesja të hesht ndaj çdo veprimi të paligjshëm të saj, kundrejt ankueses, sepse ajo e ka në dorë që të uli nga kategoria apo ti rrezikoj vendin e punës. Teksti i vlerësimit përmban si vijon: *“Soprano Sh.R në 2 vitet e fundit ka qenë e angazhuar në role dytësore që nuk kanë shumë ngarkesë skenike. Nuk ka respekt për eprorët dhe institucionin ku punon duke krijuar gjithmon tensione deri në skena jo të denja për simbolin e artistit që ajo përfaqëson. Nga ana teknike ajo nuk meriton me të jetë soprano lirike e kategorisë së dytë dhe kjo pikë del qartë në të gjitha vlerësimet që i janë bërë në audicione të ndryshme për rolet të ngjyrës vokale të sopranos dramatike që edhe ajo vetë pranon që është. Për sa më sipër propozoj, që sopranos Sh.R ti rinovohet kontrata sipas Rregullores së Brendëshme TOKBAP, duke e ulur edhe në kategorinë e tretë.”*

Pra, pas kësaj ankese, doli që kishte dhe një vlerësim për ankuesen, por kjo e fundit nuk ishte në dijeni. Pas ankimit të datës 30.09.2021 tek znj.Ç. , Drejtoreshë e Përgjithshme, ky propozimi i stisur, ra posht.

Me ardhjen e znj.V. në krye të institucionit të TKOBAP, ndaj ankueses, Drejtoria e TKOBAP, fillon procedimin disiplinor për mosmarrje pjesë në prova (ky ishte shkaku), pa e njoftuar dhe madje i kishin hequr edhe dy ditë pune, nga paga. Ankuesja vihet në dijeni të kësaj mase, kur ajo tërheq pagën në bankë. Mbas këtij momenti ajo kërkon takim me stafin e Drejtorit, për të kuptuar pse kishte dite mangut, pra të papaguara, ndërkohë që nuk kishte munguar asnjë ditë?!

Në datën 04.10.2022, sipas procesverbalit me nr. 860/1 është zhvilluar një takim midis ankueses dhe Drejtorisë së institucionit, ku prezent ishte dhe juristja e nëndrejtoresha dhe u vërtetua se znj.B., nuk kishte braktisur provat, ashtu siç ata besonin, por ka zhvilluar audicion me Jacopo Sipari dhe dirigjentin. Pas këtij momenti Drejtoria ka nxjerrë Urdhërin nr. 868/2, datë 05.10.2022, për pushimin e procedimit disiplinor për ankuesen.

Në datën 24.02.2023, ka ndodhur ngjarja e cila solli edhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme me ankuesen.

Konkretisht, në datën 24.02.2023, sopranoja znj. I.M vuri në skenë veprën e të atit, A.M, “Karnavalet e Korçës”. Ndër të tjerë solistë të përzgjedhur për këtë vepër ishte edhe ankuesja, me rolin e Dona Lucia. Në këtë datë, I.M, si regjizore, kishte planifikuar të paraprinte me provat gjenerale dhe pastaj vepra ishte gati për t’u shfaqur në skenë. Gjatë provave gjenerale, V. R (specialiste pranë Sektorit të Promocionit dhe Imazhit) ishte duke ndarë broshurat e shfaqjes, për të gjithë artistët dhe takohet me ankuesen. I jep një nga broshuarat që ajo po ndante dhe ndërkohë shfytëzon rastin e komunikon me ankuesen për shqetesimet që ajo ka patur lidhur me transmetimet në Facebook-un e institucionit, pasi ankuesja është ankuar për imazhin e transmetuar, ku asaj nuk i ishte dhënë hapësira e duhur, patur parasysh që marketingu ka për detyrë të paraqesë sekuenca të favorshme për të gjithë artistët në shfaqje. Kurse ankuesja në këtë transmetim nuk kuptohej, a ishte figurante apo po performonte, kjo në një sekond transmetim. Në krahasim me solistët e tjerë, që kishin deri në 4 sekonda transmetim dhe kuptohej edhe roli i tyre në skenë. Kurse roli i ankueses, për një sekondë, nuk kuptohej fare.Në këtë moment ankueses po i vinte radha për të

dalë në skenë, për të performuar rolin e saj dhe drejtohet për në kamerino ku kishte dhe këpucët, që ajo do të përdorte për rolin e saj. Biseda mes të dyjave po zhvillohej normale dhe V. e ndjekë nga pas për në kamerino. Ankuesja merr këpucët, del nga kamerino dhe vazhdon bisedën. Pas pak minutash shfaqet A.Gj. , Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve, pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe ndërhytë në bisedë mes V. dhe Sh., e me një ton të fortë të ashpër i drejtohet ankueses, duke thënë që nuk ke punë me V. n, mos i bëj gjë, ke punë me mua, gjë e cila nuk kishte sens për bisedën e tyre.

Me ndërhyrjen e A., biseda merr tjetër kthesë. A. ngrre zërin përkundrejt ankueses, e cila i kthehet me ton të lartë dhe çdo gjë shkon keq. Ankuesja dhe A.Gj. , nuk gjejnë rehati në këtë komunikim dhe të dyja shkojnë në Komisarariat nr.1. A., akuzon ankuesen për ushtrim dhune ndaj V. R. Kurse ankuesja akuzon A.Gj. për shpifje, pasi biseda me V. ishte krejt normale, përpara se të ndërhynte A. Me ndërhyrjen e A., biseda me V. ishte mbyllur dhe tani mosmarrveshja ishte me A.. OPGJ, pasi dëgjon palët i këshillon se këto janë situata që zgjidhen brenda institucionit dhe jo në komisarariat. Të dy zonjat, atë debat të fortë e mbyllin aty.

Ankuesja thekson se, në datën 27.12.2022, ankuesja është ankuar për punën e V.R, duke dërguar një *e-mail* në adresë të Drejtorit të Përgjithshëm, n/drejtorit të institucionit, dhe juristes, ku përveç të tjerash është ankuar edhe për banerin e shfaqes së rradhës, ku emri i saj ishte shkruar keq, i pandarë nga mbiemri, dhe shkronja e parë e emrit, ishte e ndarë nga pjesa tjetër e emrit . Ndaj V. është marrë masë disiplinore. Por ajo që të bie në sy është fakti se edhe pas një muaji nga ankesa e znj.B., ndodh e njëjta gjë. Përsëri Sektori i Promocionit, në promovimin e shfaqes Karnavalet e Korçës, për ankuesen, vendos në dispozicion vetëm 1 sekond, nga e gjithë shfaqja e shfaqur në *Facebook*, nga 4 sekonda, që kishin në dispozicion kolegët e saj.

Pas një muaji, në datën 24.03.2023, Drejtoresha e Përgjithshme, znj. A. V. , me shkresën nr.343 prot., njofton ankuesen, për fillimin e procedurës mbi vijimin e marrëdhënieve të punës, duke ju referuar ngjarjes se ndodhur në datën 24.02.2023. Në këtë shkresë i komunikohet edhe data e takimit 29.03.2023, në orën 11.00, pranë zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm. Pas takimit të mbajtur në këtë datë, në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, me prezencë të N/drejtorit dhe Juristes (në mungesë të një autorizimi të shkruar, nga drejtori), në datën 04.04.2023 Drejtori i Përgjithshëm i TKOBAP nxjerrë Urdherin nr.40, për ndërprerjen e marrëdhënieve të menjëhershme të punës me ankuesen.

Referuar Urdhrit nr.40 datë 04.04.2023 dhe ngjarjes që është diskutuar, ankuesja konstaton se:

Meqënëse në këtë urdhër flitet për veprime administrative të ndërmarra nga institucioni, takimi i datës 29.03.2023, ndryshe nga sa përmban njoftimi, shkresa nr.343 prot., datë 24.03.2023, është një hetim administrativ për të parë dhe A. lizuar veprimet e secilit person, pjesëmarrës në ngjarjen e datës 24.02.2023 dhe jo njoftim mbi vijimësinë e marrëdhënieve të punës. Nëse do të ishte kështu (pra siç është shkruar në njoftim), vendimi që ka parashikuar Drejtori i institucionit, do i ishte komunikuar në ditën e takimit datën 29.03.2023, kjo sipas (neni 144) pika 2 ku thuhet se: “Punëdhënsi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t'u marrë dhe i jep atij mundësi për t'u shprehur” dhe ankuesja, e thirrur për t'u dëgjuar, duhej të

ishite respektuar të paktën për kërkesën e saj (dhe avokates), për vënien në dispozicion të pamjeve filmike të regjistruar nga kamerat e survejimit, brenda institucionit.

Kjo nuk ka ndodhur (pra në datën 29.03.2023, nuk i është komunikuar ndonjë vendim, nuk është respektuar pika 2 e nenit 144), ky takim ka vazhduar me diskutime, pa prezencën e Drejtorit të institucionit, në prezencë të personave të tjerë të administratës, ku këta të fundit nuk kanë patur autorizim të shkruar nga Drejtori, për organizimin e këtij takimi. Autorizimi në fjalë është kërkuar nga avokatja në fillim të takimit, ku Drejtoresha e Financës dhe Juristja e institucionit u shprehën, se nuk kemi autorizim të shkruar. Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe persona të tjerë, të cilët në fakt sipas nenit 144 të Kodit të Punës, nuk duhet të ishin prezent në atë takim, sepse takimi është parashikuar të zhvillohej ndërmjet punëdhënësi dhe punëmarrësit dhe tema e diskutimit ka qenë, vijimësia e marrëdhënievetë punës me punëmarrësin.

Zhvillimi i një hetimi administrativ, ka disa rregulla të cilat nuk mund të shkelen dhe këto rregulla procedurale, janë të domosdoshme të respektohen, si në çdo procedurë tjetër. Ne nuk e dimë se me çfarë cilësie janë thirrur në këtë takim, A.Gj. , Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve dhe Imazhit dhe V.R, si Specialiste e Promocionit dhe Imazhit, ndërkohë që takimi kishte temë tjetër diskutimi!!?? Nëse janë thirrur si dëshmitare, dëshmitari nuk mund të rrijë gjatë gjithë kohës (pra takimit) deri në mbarim të hetimit, apo t'i diktoj personit tjetër se si duhet të flasë apo deklaroj, se pastaj humb vlerën dëshmia. Dhe kjo ka ndodhur rëndom, kur A.Gj. , i ka kërkuar V., “thuaje kështu, pse nuk e thua” (shikoni procesverbalin e datës 29.03.2023). Ankuesja thekson se, takimi duhej të ishte zhvilluar ndërmjet Drejtoreshës si punëdhënësi dhe Sh.B (B) si punëmarrës.

Kur institucioni shprehet, se ka patur “ngjarje” në datë 24.02.2023 dhe nuk e ka marrë në shqyrtim brenda një afati të arsyeshëm, ngjarjen, por pas 35 ditësh, kjo do të thotë se nuk ka krijuar shqetësim për institucionin.

Duke vlerësuar kohëzgjatjen, ankuesja shprehet se, nuk ka patur ngjarje, se po të kishte qënë e tillë, institucioni do ta kishte marrë në shqyrtim, në atë datë ose një dite më pas, ose duhej të ishte marrë në konsideratë nga Drejtori, *e-maili* i dërguar nga Sh. për këtë situatë, paraditen e datës 24.02.2023, por jo pas 35 ditësh. Kur shkaqet janë zhdukur, secili i është kthyer normalitetit, aktorët e ngjarjes kanë reflektuar dhe kanë ndryshuar sjellje (kjo për mirë), nuk i kthehet kush më asaj ngjarje. Lind pyetja, a ka detyrim ligjor që institucioni të marrë në A. lizë, *e-mail* e dërguar nga Sh.? Sipas Kodit të Punës, çdo lloj shqetësimi që punonjësit kanë, e para informojnë drejtuesin dhe e dyta, nëse informacioni është shqetësues, ky i fundit (pra drejtuesi), merr masa të menjëhershme. Në rastin konkret, reagimi është zero.

Si është e mundur që pasi të dy zonjat, B. e Gj., në Komisariat i kanë dhënë fund mosmarrëveshjes dhe pas disa ditësh mësojmë se A.Gj. paska bërë një denoncim të ri i njëjtë me të parin. Nëse është e vërtetë që ka patur denoncim, lind pyetja, çfarë e detyroi A. Gj të bëjë edhe njëherë denoncim në Komisariat? Mos ndoshta znj.B., pati një konflikt të ri me të? Apo është bërë e qëllimshme nga A.Gj. ?!

Nga sa shikohet në proceverbalin e datës 29.03.2023, A.Gj. ka pohuar se, pas datës 24.03.2023, nuk ka patur asnjë kontakt me Sh. B. Atëherë shtrohet pyetja, kush ishte gjëja e re që e detyroi

A.Gj, të bënte denoncim të ri? Nga të dhënat e sipërpërmendura, nuk del asgjë e re, por që kuptohet fare qartë se kjo ka patur si qëllim (prapaskenë), ndëshkimin e Sh.B.

Veprimet e Drejtorit, pas 35 ditësh janë dashakeqe dhe të qëllimshme. Kthimi edhe njëherë i kësaj “ngjarje” në memorien e personave pjesëmarrë në të, ndërkohë që gjithçka ishte mbyllur mes tyre, ka patur si qëllim vetëm ndëshkimin e Sh.B dhe jo zbardhjen e së vërtetës. Pasi po të kishte qenë synimi i zbardhjes se të vërtetës, kuptohet fare qartë se personi i cili është shkaktari i kësaj ngjarje A.Gj. , do të ishte ndëshkuar me masë disiplinore. Në fakt ka ndodhur e kundërta.

Referuar dokumentave shkresore, proceverbali i datës 29.03.2023, shkresës nr.343 prot., njoftimit të datës 24.03.2023, Urdhërit nr.40 datë 04.04.2023, konstatohen shkelje të procedurës së “takimit”, bazuar në nenin 144 të Kodit të Punës, shkelje të Kontratës Kolektive të Punës nr.329 prot., datë 18.12.2007, neni 2 dhe 14, shkelje të nenit 25, të Rregullores së Brendshme të institucionit, Kodit të Punes, në nenet 37 dhe 144, Kodi i Procedures Administrative.

Neni 2 i kësaj kontrate përcakton se: “kur kontrata individuale përmban kushte më pak të favorshme sesa kontrata kolektive e punës, punëmarresi do të mbrohet me kontratën kolektive të punës”,

Neni 14 të kësaj kontrate “për shkeljet dhe masat disiplinore”, është parashikuar ngritja e një komisioni dy palësh, në mbrojtje të interesave të ligjshme të punëmarrësit dhe punëdhënësit. Ky komision ka në përbërje të vet, përfaqësues nga të dy palët, përfaqësues nga punëdhënësi dhe Sindikata. Detyra e këtij komisioni është përcaktimi i llojit të fajit, nëse është i lehtë apo i rëndë.

Neni 37 i Kodit të Punes ku thuhet “masat disiplinore që parashikohen në kontratën kolektive të punës, në çdo rast kontrata individuale, duhet t’i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore. Procedurat e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojnë të drejtën e punëmarrësit, për t’u dëgjuar, mbrojtur, për të parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm”.

Neni 144 pika 2 thotë se, “*Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t’u marrë dhe i jep atij mundësi për t’u shprehur*”.

Neni 77 “*Parimi i hetimit kryesisht*”: 1. Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.

Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për zhvillimin e hetimit administrativ, administrohen kryesisht nga organi që zhvillon procedurën administrative, kur janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t’i kërkojë palës vetëm elementet e nevojshme për identifikimin e tyre.

Akte juridike dhe ligje, të cilat në harmoni me njëra tjetrën përcaktojnë, ligjshmërinë një veprimi apo mosveprimi, janë rregulla që në rastin konkret nuk janë marrë parasysh nga institucioni, për të

vlerësuar kategorinë e shkeljes, si dhe masën disiplinore, e cila duhej aplikuar. Parë në këtë këndvështrim ligjor, ankuesja shprehet se kemi të bëjmë me shkelje procedurale dhe vlerësim ligjor të gabaur, që kanë çuar institucionin në një urdhër përfundimtar të pavlefshëm (nul).

Sa më sipër, ankuesja pretendon se, znj. A. V. , sot Drejtore e Përgjithshme e TKOBAP, e ka diskriminuar në mënyrë të vazhdueshme, në raport me kolegët e tjerë, si kur ishte në pozicionin Drejtore Artistike, ashtu dhe në pozicionin që mban sot, në cenim të të drejtave të saj ligjore si punëmarrëse, duke arritur deri në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri shfuqizimin e urdhrit për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës dhe rikthimin e saj në pozicionin e mëparshëm të punës.

Referuar dispozitave ligjore, si dhe veprimeve të ndërmarra nga institucioni në kategorizimin e shkeljes si dhe masës disiplinore të aplikuar, ankuesja pretendon se ka shkelje të dispozitave kryesore të ligjit që rregullon marrëdhëniet e punës dhe kontratat respektive (citohet: neni 11, 11/1, 12 dhe 159 të Kodit të Punës).

E para, ka shkelje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Kodi i Punës, Kontrata Kolektive e Punës, si dhe Rregullores së Brendshme, në aplikimin e masë disiplinore.

E dyta, nuk është njoftuar sindikata, si subjekt juridik, që ka përfaqësuar punëmarrësin në lidhjen e kontratës kolektive të punës dhe subjekti tjetër nënshkrues i kontratës kishte detyrimin ligjor të lajmëronte palën tjetër (ky detyrim rrjedh si nga kontrata ashtu edhe nga përmbajtja e nenit 11/1, të ligjit).

E treta, nuk janë respektuar parashikimet e nenit 14 të Kontratës së Punës Kolektive, e cila është detyrim ligjor, për secilin subjekt nënshkrues.

E katërta, është shkelur në mënyrë arbitrare neni 25 i rregullores, ku në pikën 5, germa “b”, thuhet shprehimisht: *“për shkeljet e rënda aplikohet, vërejtje me shkrim, në rast të marrjes së dy vërejtjeve me shkrim, brenda 6 muajve, pushim i menjëhershëm nga puna”*

Në rastin konkret jemi përpara aplikimit të masës së fundit disiplinore, akt ekstrem, pushimin e menjëhershëm nga puna, pa u plotësuar kushtet e parashikuara në pikën e parë të pikës b. Institucioni ka filluar numërimin mbrapsht dhe jo nga fillimi, siç duhet të ishte në fakt.

Ankuesja pretendon se, ka shkelje të nenit 37 dhe 144/2 të Kodit të Punës. Në lidhje me këtë pretendim, ankuesja pretendon se, sipas procesverbalit të takimit të datës 29.03.2023, avokati i ankuses dhe vetë ankuesja, kanë kërkuar vënien në dispozicion të pamjeve filmike të regjistruara nga kamerat e institucionit, që i përkasin regjistrimit të datës 24.02.2023, me qëllimin që të shikohej sjellja e secilit prej personave që kishin mosmarrëveshje mes tyre, dhe nuk i kanë dhënë pamjet. Personat që kanë qënë në takim, M. D (drejtorja e financës) dhe juristja M. B, nuk kanë pranuar justifikimin që nuk mund të shtyhet takimi, që do të thotë se ka mohim të së drejtës së

punëmarrësit për t'u mbrojtur. Pasja në dispozicion e këtyre regjistrimeve tashmë është kthyer në "luks", pasi drejtorja nuk pranon t'i jap, pa çka se e ka detyrim ligjor të vëjë në dispozicion të punëmarrësit çdo gjë që ka lidhje me mbrojtjen.

Nga procesverbali i datës 29.03.2023, ankuesen e kanë vënë padrejtësisht nën akuzë, pa marrë parasysh se kush ishte shkaku i kësaj "ngjarje". Në diskutimin që ka patur ankuesja me V., e para, nuk ka shkuar ankuesja tek V., por V. tek ankuesja. E dyta, ankuesja i ka kërkuar V. arsyen se pse filmimet e bera nga ajo, imazhi i saj skenik shfaqet në pak sekonda, aq sa nuk kuptohet nëse ka marrë pjesë në shfaqje apo jo?? Kjo duhet të vinte në shqetësim institucionin në radhë të parë dhe pastaj ankuesen. Por ndodh e kundërta, me parë vihet në shqetësim ankuesja, kurse institucioni bën sehire (citim fjalë për fjalë sipas ankesës: *po përdorim këtë fjalë, se i shkon për shtat sjelljes së tyre*)

Gjatë diskutimit midis ankueses dhe V., shfaqet një person i tretë, A.Gj., që sipas ankueses, nuk e kupton se me çfarë tagri hyn në mes të diskutimit????..., ajo nuk është drejtuese e institucionit, kujdetare jo, kujdestare konvikti jo?!... është Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve të Imazhit, e cila nëse kishte ankesa administrative t'ia referonte Drejtorit të Përgjithshëm. Kjo është hierarkia administrative, për ndryshe puna shkon me ngritje zëri, ofendime, "shkeje të etikës" etj. Shkaktari edhe pse dihet, nuk ndëshkohet, nuk vihet para përgjegjësisë, por ledhatohet. Ajo që nuk është shkaktare, ndërshkohet me masën më ekstreme.

I gjithë takimi i planifikuar, ku temë e diskutimit ka qenë planifikuar "*njoftim për fillimin e procedurës mbi vijimin e marrëdhënieve suaj të punës*", degjeneron në një mbledhje të këshillit popullorë të lagjes. Ky takim del jashtë objektit të takimit. Kjo shihet nga numri i pjesëmarrësve. Takimi duhej të zhvillohej midis Drejtorit të Përgjithshëm (si punëdhënës) dhe ankueses (si punëmarrëse bashkë me sindikatën, që është injoruar prania e saj nga institucioni) dhe askush tjetër. Prania e A. Gj. dhe V. R., ndryshon krejt qëllimin e takimit. Këta të fundit për nga tema e diskutimit, nuk duhej të merrnin pjesë në takim, pasi nuk kanë tagrin e punëdhënësit. Prania e tyre në takim, ka zhbërë qëllimin e takimit. Diskutimi i zhvilluar në këtë takim, i ka vënë vulën e së keqes. Që do të thotë, se ka shkelje procedurale për zhvillimin e takimit, kur flitet për takim të organizuar nga Drejtori i institucionit, bazuar në nenin 144 të Kodit të Punës.

Bazuar në nenin 144, pika 2, të Kodit të punës, ankuesja pretendon se, në këtë takim duhet të merrte pjesë titullari i institucionit, si punëdhënës, ankuesja, si punëmarrëse dhe avokati i saj dhe duhej ti bëhej prezent ankueses, vendimi i punëdhënësit dhe të dëgjohej punëmarrësi lidhur me këtë vendim. Në fakt në takim është diskutuar për gjëra krejt të tjera, por nuk është diskutuar për objektin e takimit.

Nëse TKOBAP ka patur si qëllim të bëjë hetim administrativ, është në shkelje të nenit 77, të K.Administrativ, pasi duhet të respektohen rregullat procedurale, që kanë të bëjnë me objektin e takimit ashtu edhe me zhvillimin e mëtejshëm të diskutimit. Për sa i përket provimit të "fajësisë"

apo “shkeljes së etikës” apo “dhunës verbale” të pretenduara, nëse ka ndodhur kjo apo jo, barrën e provës e ka ai që pretendon, lidhur me sjelljen e ankueses.

Sipas ankueses, nuk dihet se me çfarë cilësie janë thirrur A.Gj. apo V. R. Nëse janë thirrur si dëshmitare, ato nuk mund të rrinin më tepër në zhvillimin e kësaj seance, sesa të dëshmonin. Ndërkohë ato janë thirrur të dyja në një kohë dhe kanë marrë pjesë deri në përfundimin e seancës. Madje, A.Gj. , ka ndikuar në dhënien e përgjigjeve tek V. ? Një proces i paanshëm është atëherë kur dëshmitarët pyeten një e nga një pa patur ndikim të jashtëm në dëshmitë e tyre. “Takimi” ka marrë trajtën e një pazari “fruta perimësh”.

Referuar procesverbalit të datës 29.03.2023, përgjegjësja e sektorit të menaxhimit, ka marrë rolin e drejtuesit të institucionit, duke u konfliktuar me ankuesen. Me habi, ankuesja shprehet se në procesverbal nuk ka asnjë fjalë për sjelljen e A. Gj. , që sipas saj është e vetmja shkaktare e këtij konflikti me ankuesen, nëse është e drejtë ndërhyrja e saj në këtë dialog apo e gabuar. Si është e mundur që znj.B. të marrë një ndëshkim kaq të rëndë për “shkelje etike” dhe ajo që është shkaktare e shkeljes së etikës nuk ka marrë asnjë vërejtje!!!! Mos kemi të bëjmë me një ngjarje të mirëmenduar më parë?? Referuar të gjitha deklarimeve në procesverbal nga A. e A. Gj. , vërehet se sjellja e saj ndaj znj.B. është e qëllimshme. Fakti që ajo, me gojën e saj ka pohuar se, ka qenë ajo që ka ndërhyrë në bisedë mes V. dhe ankueses, tregon që është shkaktare e të gjithë kësaj ngjarjeje, duke pretenduar se po mbron V., kur në fakt nuk kishte arsye.

Ankuesja pretendon gjithashtu se, është shkelur neni 25 i Rregullores së Brendshme. Sipas të gjitha të dhënave që pasqyron procesverbali i datës 29.03.2023, ankuesja nuk rezulton të ketë konsumuar me sjelljen e saj, thyerje të etikës, ndonjë nga pikat e parashikuara në këtë nen, ndaj institucionit apo punonjësve të tjerë që shërbejnë aty. Nga i gjithë diskutimi i pasqyruar në këtë procesverbal, nuk del në pah sjellja joetike profesionale e ankueses. Por ajo që nuk është as profesionale dhe as etike, është sjellja e A. Gj. , e cila pa asnjë tagër shkon dhe merr “flamurin” e një diskutimi, që nuk është as normale në kuptimin logjik. Shikohet fare mirë që A. ka dashur të bëjë “cubin” (citim fjalë për fjalë sipas ankesës: fjalë popullore, mos e keqkuptoni), ndërkohë që detyra e saj është të relatojë tek titullari.

Përfundimisht, ankuesja shprehet se, vërehet qartë dhe provohet gjithashtu se, sjellja e saj ndaj personave të tretë apo V. s nuk ka qenë jashtë etikës apo dhunës verbale, por është një sjellje brenda normave të etikës. Kurse ndaj znj.A.Gj. , është sjellje e diktuar prej saj, pra sjellje provokuese. Nuk mundet që kur një personi t’i drejtohesh me tone të lartë, tjetri të mos reagojë. Ky është instikt natyral, që e ka çdo njeri.

Në lidhje me marrëdhëniet e ankueses me Drejtorin e Përgjithshëm, sipas ankueses shihet qartë se Drejtori i Përgjithshëm ka demonstruar mllef të brendshëm që e ka filluesën kur ajo ishte Drejtore Artistike, ku asnjëherë nuk e ka vlerësuar siç duhej përgatitjen profesionale dhe artistike të ankueses, por ka gjetur forma të ndryshme që solistja të mos merrte pjesë në shfaqje dhe evenimente, duke i thënë se ka probleme teknike. Ndërkohë ankuesja edhe pas vlerësimeve të

njëanshme të drejtores artistike ka korrur sukses në shfaqje edhe pse ka mbartur mbi supë presionin psikologjik të vazhdueshëm, diskriminimin profesional si artiste, nga znj.V. , deri sa ankuesja u detyrua ta çonte çështjen në Prokurorinë e Tiranës. Sepse, sipas ankueses, znj.V. , audicionet dhe vlersimet (që sipas rregullores bëhen për të gjithë artistët, në bazë të ngritjes së një komisioni), në shumicën e rasteve, në raport me ankuesen, këto audicione bëheshin vetëm nga ajo (pa komision). Pra, duket qartë se znj.V. , përveç se ka ushtruar presion psikologjik dhe e ka diskriminuar ankuesen, shpërdoron dhe postin.

Pra, meqënëse znj.V. nuk ia arriti dot qëllimit për ta hequr nga puna ankuesen si të paaftë profesionalisht kur ishte drejtore artistike, ia arriti kur u bë Drejtore e Përgjithshme, duke e nxjerrë solisten si dhunuese. Ankuesja pretendon se, institucioni ka arsyetuar me subjektivitet dhe jo me objektivitet sjelljen e saj, pa marrë në konsideratë sjelljen e aktorëve të tjerë në këtë mosmarrëveshje.

Nga konteksti i të gjitha provave, ankuesja pretendon se nuk kemi një cilësim juridik të rrethanave të rënda, prandaj ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës, bazuar në nenin 153, 154 të Kodit të Punës, është absolutisht e pavlefshme, e bërë në kundërshtim me normat ligjore të parashikuara nga K.Punës.

Referuar veprimeve të institucionit, urdhrin administrativ nr.40, datë 04.04.2023, i cili bie në kundërshtim me Kodin e Punës, Kontratën Kolektive të Punës, Rregulloren e Brendshme të institucionit, përfundimisht, ankuesja kërkon nga Komisioneri:

- Shfuqizimin e urdhrin nr.40, datë 04.04.2023 për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës për ankuesen dhe anëtarin e Sindikatës së Artistëve të TKOBAP, znj. Sh.B..
- Rikthimin në pozicionin e saj të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1, të LMD përcaktohet: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethA. të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

1. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr.144 datë 18.07.2023, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë për të vijuar më tej shqyrtimin e saj. Me anë të e-mailit datë 24.07.2023, ankueses iu kërkua plotësimi i ankesës. Me shkresën nr.860/2 prot datë 28.07.2023, ankuesja depozitoi pranë Komisionerit informacionin plotësues në lidhje me ankesën³, duke parashtuar se, diskriminimi ndaj ankueses ka ndodhur në mënyrë permanente vazhduese deri në momentin që asaj i ndërpriten marrëdhëniet e punës, si më poshtë vijon:

“Në muajin Tetor/2019, në pozicionin e drejtoreshës artistike znj.V. , zhvilloi audicionin për veprën artistike Cavaleria Rusticana, e cila ishte pjesë e kalendarit artistik TKOBAP. Në përberje të komisionit ishte znj.V. në funksionin e kryetarit, dhe dy antarë z.G. e znj.D.K (shoqja e A. V., pa asnjë funksion në TKOBAP). Vlerësimi i bërë nga komisioni ishte ky, kryetari V. (17 pikë), anëtari i komisionit znj.K. (28 pikë), profesori i kantos z. G, dhe regjizor i veprës, vlerëson solisten me (44 pikë). Pra siç shikohet, vlerësimi i solistes nga kryetari i komisionit znj.V. dhe një anëtare i komisionit znj.K., ishte krejtësisht tendencioz dhe skandaloz. Ky vlerësim solli skualifikimin e solistes, nga kjo vepër dhe e nxorri atë të paaftë profesionalisht, duke e çmuar nivelin e saj, sikur ishte një koriste dhe jo soliste e Teatrit. (Kjo vërtetohet me shkresën nr.695/I prot., datë 17.12.2019, kthim përgjigje, që i është bashkangjitur ankimi) Për këtë vlerësim, solistja është ankuar tek Drejtori i Përgjithshëm me ankesën e datës 06.11.2019 dhe ka kërkuar ngritjen e një komisioni tjetër, për vlerësimin real të saj, pasi nuk ka qenë dakort me vlerësimin e bërë nga znj.V. dhe znj.K.. Drejtori i Përgjithshëm, në kthim përgjigjen e datës 25.11.2019, nr.636/I prot., sqaron se kjo vepër është hequr nga kalendari. (Kjo shkresë do ju bëjmë prezent)

Pjesë e diskriminimit është edhe sjellja e movonshme e ndodhur me datë 03.07.2020, ku sipas shkresës me nr.225 prot., jemi vënë dijeni të kërkesës për uljen nga kategoria, të solistes. Propozim i bërë ky nga dirigjenti, i pranuar nga znj.V. (dr.artistike) dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Me venien në dijeni të ekzistencës së këtij propozimi, pas nje viti (dt.27/09/2021), kam bërë ankim administrativ me datë 30.09.2021, për të cilin nuk kemi marrë përgjigje, por di, që nuk është bërë asnjë veprim lidhur me këtë propozim. (Bashkëlidhur ankimit, janë depozituar shkresa për këtë vlerësim data 03.07.2020 dhe ankimi administrativ me datë 30.09.2021)

Referuar këtyre sjelljeve të demonstruar nga znj.V. , e cila ishte Dr.Artstike, ku nuk më aktivizonte për të dalë në skenë (pra nuk me ka dhënë punë),ku skena për mua u bë një “mollë e ndaluar”, kam reaguar me e-mail dhe ankesa pa fund, duke u ankuar tek drejtori i përgjithshëm, ku ndër to do të përmend email dt.11.11.2019, ankesën nr.518 prot., dt.13.09.2019, nr.406 prot., 06.10.2019,

³ Informacioni plotësues është dërguar edhe me postë elektronike, me email datë 27.07.2023.

nr.636 prot., dt.06.11.2019, nr.695 prot., dt.25.11.2019, nr.40 prot., dt.23.01.2020.Në këto kërkesë-ankesa të protokulluara, kam denoncuar diskriminimin në mënyrë të vazhdueshme që znj. V. , ka demonstruar ndaj meje. Ankesa lidhet me mohimin e daljes time në skenë, me skualifikimin tim pa komision, duke bërë vlerësime personale, gjë e cila është në kundërshtim me rregulloren e institucionit dhe për ironi, kjo sjellje e Drejtoreshës Artistike znj.V. , nuk reflektohej me kolegët e tjerë, që do të thotë se ajo e kishte çdo gjë personale me mua. Për këtë qëndrim të Drejtoreshës Artistike znj.V. , ka reaguar sindikata e TKOBAP, duke e vlerësuar sjelljen e saj, si të pakonceptueshme në raport me znj.Sh. B. (B), duke ju drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me kërkesë për takim. Kërkesa mban nr.606 prot., dt.16.10.2020.

Në vazhdim, jam diskriminuar edhe në mospjesmarrjen në netet Gala të zhvilluar në dt.15.09.2021 dhe dt.16.09.2021, të inagurimit të TKOBAP. Një eveniment tepër i rëndësishëm për të gjithë punonjësit e saj, pasi u kthyem në godinë mbas 3 vitesh rikonstruksion. Për çdo artist që punon dhe kontribon në këtë institucion dhe jo vetëm, por edhe për të gjithë artistat që i kanë dhënë skenës për vite me radhë (që sot janë në pension apo janë jashtë vendit), kjo ditë ishte një ditë e shënuar për ta. Si Drejtoreshë Artistike znj.V. , përzgjedhi programin që do të prezantohej në të dy netët e Galasë dhe caktojë materialet për përgatitje, për çdo solist. Nata e parë ishte me prokoll dhe nata e dytë ishte për publikun e gjerë. Theksojmë se: Për natën e parë të Galasë, znj.V. (drejtoreshë Artistike) me caktoi, si shoqëruese e Solites K. , ku ajo do të këndonte arjen e Carmen, nga opera Carmen. Mua nuk më dha material solo, por do të shoqëroja me një pasazh, solisten kryesore (me një tra-la-la). Gjendur përpara këtij propozimi, refuzova të kem rolin e shoqërueses në këtë event dhe kërkova që të më lihej hapsirë për interpretim, të nje materiali solo, sikurse kolegja në fjalë. Ky vlersim i znj.V. për mua, ishte ofendues dhe nënvlersues, patur parasysht eksperiencën, vitet e punës si soliste, kontributin tim në skenën e TKOBAP dhe vlerat mia si artiste. Të gjithë kolegëve, ju kishin lënë hapsirë interpretimi, madje edhe përzgjedhje materiali (pra mund të këndonin çfarë të donin nga repertori i tyre) kurse mua jo. Pra diskriminim i hapur që më është bërë, në raport me kolegët e tjerë. Për natën e dytë të Galasë, znj. V. kishte planifikuar që për arjen e Mrikës, të konkuronin 4 soliste, përfshirë dhe mua. Materjali u përgatit nga të 4 solistët, ku bëmë prova me orkestër, deri 2 ditë përpara se të vinte dirigjenti i huaj (M. A). Isha në pritje të vlersimit të Drejtoreshës Artistike, për arjen e Mrikës dhe reagoval me e-mail, pasi nuk dija pozicionin tim. I jam drejtuar me e-mail, përgjegjësit të sektorit, drejtoreshës artistike dhe të përgjithshme, sepse po afrohej dita e shfaqes dhe unë duhej të dija, se cili do ishte pozicioni im në shfaqje. Por përsëri nuk mora përgjigje. Ajo që ndodhi me pas ishte, që materiali arja e Mrikës, i ishte caktuar solistes R.L. Kurse dy koleget e tjera dhe unë, ngelëm bosh. Gjeja më e çuditshme që ndodhi, ishte se, dy kolegeve të tjera ju dha material tjetër, nga Drejtoresha Artstike, për të dalë në skenën e Galasë, kurse mua jo. Por u përjashtova, pa asnjë arsye nga Galaja.

Kjo sjellje, është dukshëm një diskriminim dhe kjo shihet qartë se si jam trajtuar unë, në raport me kolegët e tjerë. Për këtë sjellje të znj.V. , ka reaguar dhe sindikata me kerkesën nr.513 prot., dt.11.06.2021, ku sjellje e saj e ka cilësuar diskriminuese, në raport me solisten B. (B).

Diskriminimi ka ndodhur në muajin shtator 2022, ku më njoftojnë për fillim të procedimit disiplinor (me email), me heqjen e dy ditëve pune, me pretendimin, se nuk kisha marrë pjesë në prova, për shfaqjen Cavalaria Rusticana . Masa administrative i dha efektin e vet menjëherë, ku mua si soliste më kishin mbajtur nga rroga, 2 ditë pune. Siç shikohet edhe në proceverbalin e mbajtur në takimin e dt.04.10.2022 me nr.860 prot., në zyrën e juristes dhe në prani të Drejtorit të Përgjithshëm, sqarova dhe provova para tyre, se kisha marrë pjesë në prova dhe këtë e vërtetoi edhe Përgjegjësja e Sektorit znj.E.I. Pasi dola e pafajshme, me Vendimin nr.860/2 prot., dt.05.10.2022, u anulua procedimi disiplinor dhe në muajin tetor mu kthyen 2 ditë pune. E gjithë kjo ka ndodhur 4 ditë para shfaqes Cavalaria Rusticana . Vlersojeni ju se çfarë demi moral, emocional, diskriminues dhe stres, më ka sjellë znj.V. , 4 ditë para shfaqes!

Pjesë e diskriminimit është edhe fakti që në banerat e shfaqeve të muajve shtator dhe dhjetor të 2022, emri i solistes nuk shfaqet ose është shkruar gabim. Për banerin e shtatorit reagues të gjithë solistet dhe kjo vërtetohet me proceverbalin e dt.04.10.2022, ku solistja shprehet lidhur me heqjen padrejtesisht të dy ditëve punë. Kurse lidhur me banerin e dhjetorit, solistja ka reagues me emalin dt.27.12.2022 drejtuar, Drejtorit të Përgjithshëm, N/drejtorit të institucionit dhe juristes, ku për veç të tjerash është ankuar edhe për banerin e shfaqes së radhës, ku emri i saj ishte shkruar keq, i pa ndarë nga mbiemri dhe shkronja e parë e emrit, ishte e ndarë nga pjesa tjetër e emrit (SHB.). Përveç kësaj, sektori i promocionit, në promovimin e shfaqes Karnavalet e Korçës, për solisten, kanë lënë në dispozicion vetëm 1sek, nga e gjithë shfaqja e shfaqur në fb, nga 4 sek. që kishin në dispozicion koleget e saj.

Të gjitha këto veprime, të bëra enkas për të dëmtuar imazhin skenik dhe artistik timin, nuk është se janë bërë pa dijeni të dikujt nga Drejtoria, se po të ishte kështu, nuk ka sesi punonjësja të shprehet, se merr urdhëra nga të tjerët. Punonjësja e promovimit, nuk e nxorri nga xhepi këtë fjalë, por e tha shqeto pa ndroje, pasi kjo ishte e vërteta. Çfarë mund të quhet kjo? Pakujdesi i punonjësës së marketingut? Inat personal i punonjësës, që kishte vetëm disa javë pune në institucion, apo i dikujt me lart që ishte i interesuar të më sillte shqetësime mua, hap pas hapi? Kjo e fundit është mëse e kuptueshme.

Znj. V. , duke qenë se me mua kishte patur përplasje të hershme, tani në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm, e kishte më të lehtë të arrinte qëllimin e saj, që të më largonte nga puna. Siç shikohet, përdorë punonjësit, për të mos dalë vetë në skenë. Ajo e din shumë mirë se (pra znj.V.), provokimi i një artisti, duke mos e promovuar si imazh artistik, artistit i krijon dëm profesional, stres dhe diskriminim, pasi artisti e sheh veten të nënvlerësuar, në raport me koleget.

Me dt.24.03.2023, nëpërmjet shkresës nr.343 prot., jam njoftuar për një takim të thirrur nga Drejtori i institucionit me dt.29.03.2023, ku vihem në dijeni të fillimit të procedurës për vazhdimsinë e marrëdhënievetë punës. Mbas takimit të zhvilluar nga administrata, pa prezencën e Drejtorit, që më kishte thirrur takim, me dt.04.04.2023 del dhe Vendimi nr.40 i Drejtorit për ndërprerjen e marrëdhënievetë menjëhershme të punës. Nga sa shohim nëpërmjet dokumentave konstatoj se:

-shkelje të procedurës së “takimit”, bazuar në nenin 144 të Kodit të Punës, shkelje të kontratës kolektive të punës nr.329 prot., dt.18.12.2007 neni 2 dhe 14, shkelje të nenit 25 të Rregullores së Brendshme të institucionit, Kodi i Punës në nenet 37 dhe 144, Kodi i Procedurës Administrative.

.....akte juridike dhe ligjore, të cilat në harmoni me njëra tjetrën përcaktojnë ligjshmërinë e një veprimi apo mosveprimi, janë rregulla që në rastin konkret nuk janë marrë parasysh nga institucioni, për të vlersuar kategorinë e shkeljes, si dhe masën disiplinore e cila duhej aplikuar. Parë në këtë këndvështrim ligjor, shprehemi se kemi të bëjmë me shkelje procedurale dhe vlersim ligjor të gabuar, që kanë çuar institucionin në një urdhër përfundimtar të pavlefshëm (nul).

Referuar shkeljeve të mësipërme, konstatojmë se punëmarrësit i është mohuar e drejta për të marrë prova (këto filmike nëpërmjet kamerave të institucionit), edhe pse ka paraqitur kërkesë të veçantë, gjë që bën të qartë, se punëmarrësit i është mohuar e drejta për t’u dëgjuar dhe mbrojtur.....”

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

2. Me shkresën me nr. 860/3 prot., datë 07.08.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga TKOBAP, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, me shkresën nr.919/1 prot., datë 17.08.2023 TKOBAP ktheu përgjigje në lidhje me ankesën, duke parashtruar si më poshtë:

Znj. Sh.B (B) është punësuar pranë TKOBAP më 1.10.1999, sipas shënimeve në librezën e punës dhe marrëdhënia e saj e punës është ndërprerë në datën 04.04.2023, sipas procedurës së ndjekur dhe urdhrit të titullarit të TKOBAP.

Në një nga *e-mail*et e vitit 2019, nga znj. V. , asokohe Drejtor Artistik pranë Drejtorisë së Operas dhe Filamonisë, e cila ka në varësi Solisten e Dytë Lirike znj. Sh. B. , i shpreh shqetësimin ish drejtorit të përgjithshëm të TKOBAP, në lidhje me punën e ankueses.

Znj.B. pas një sërë *e-mailesh* dhe përgjigjesh të marra nga Drejtori Artistik lidhur me problematikat që shfaqte, me këmbënguljen e saj, edhe pse përgjigjet kanë qenë shteruese, me fokus vetëm përmirësimin në rolet që i besoheshin ose në ato role të cilat ajo i kërkonte me patjetër që ti performonte, pretendonte për mosdhënie të rolit, duke krijuar vazhdimisht polemika me të gjithë aktorët pjesëmarrës.

Në lidhje me vlerësimin artistik të nr.225 prot datë 03.07.2020, sipas praktikës së ndjekur në institucion, punonjësit të cilit i përfundon kontrata e punës i bëhet një vlerësim artistik dhe pas miratimit nga drejtori i përgjithshëm, vijohet me nënshkrimin e kontratës së re të punës. Në këtë vlerësim të bërë nga dirigjenti i orkestrës z. E.D është propozuar ulja në kategori. Me urdhrin nr.225/1 prot datë 10.07.2020 është urdhëruar rinovimi i kontratës së punës me ankuesen në pozicionin e punës Solisti Dytë Lirik. Për sa më sipër, pretendimi se pas ankimit të datës

30.09.2021 tek znj. Z.Ç , Drejtore e Përgjihshme, ky propozim i stisur ra poshtë, nuk qëndron, pasi znj.Sh.B. ka vijuar të paguhet edhe në bazë të urdhërit 225/1 prot datë 10.07.2020 si Soliste e Dytë Lirike. Vlerësimi artistik është pjesë e praktikës para rinovimit të kontratës së punës dhe nuk është i stitur, ai është i protokolluar dhe mban datën 03.07.2020 me nr.225 prot.

Në vlerësimin artistik të datës 14.06.2021 “Cavallier Rusticana ” dërguar drejtorit artistik znj.V. , me e-mail ku tregon se nuk ka inat personal ose profesional me znj. B. .

Lidhur me pretendimin e rastit të ndodhur në datë 15.09.2021 dhe 16.09.2021 arsyet se pse znj.B. e sheh veten jashtë eventit “Premiera Grand Gala e Inagurimit të TKOBAP-së”, informon se: *Solistja Lirike znj.Sh.B. nuk pranoi të interpretojë rolin “Mercedes” me arsyetimin “fyerje e figurës artistike” gjatë mbledhjes së zhvilluar në muajin korrik nga Drejtori Artistik i Operas dhe Filarmonisë. Si rrjedhojë mosprezenca e solistes në Grand Gala ka qenë zgjedhje e saj pa asnjë pasojë ekonomike me masë disiplinore të propozuar nga kjo drejtori për mos kryerje të rolit.* Lidhur me këtë pretendim Drejtori Artistik ka vënë në dijeni nëpërmjet e-mailit zyrtar edhe Sindikatën e Artistëve. Në datën 30.09.2021 ankuesja ka paraqitur kërkesë ankimore për kundërshtimin e aktit administrativ datë 03.07.2020 nr.255 prot, vlerësimin artistik, shpalljen e paligjshme të tij.

Në kthim përgjigje të shkresës datë 19.10.2021 me nr.559/1, citohet: “...Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive ose dobësive të punonjësit në kryerjen e detyrave, që realizohet periodikisht. Ky vlerësim synon përmirësimin e aftësive profesionale të punonjësit dhe të cilësisë së shërbimit.” Stafi vlerësues i këngëtarëve solist është i përbërë nga Dirigjent, regjizor dhe Drejtori Artistik (në çdo vënie skenike-opera). Këtu përmendim vlerësimin e solistes për operan koncertale “Un ballo in Maschera” nga Maestro S.R, në muajin mars 2021. Në këtë rast vlerësimi është bërë nga Dirigjenti dhe Drejtori Artistik, sepse në këtë formë u vu opera në skenë pa regji. Kjo është një praktikë e konsoliduar e institucionit, sikundër është vepruar po njëjloj edhe në rastin e operas “Cavalliera Rusticana ” e cila u bë në maj të vitit 2021 dhe ankuesja nuk e kundërshton, pasi Drejtori Artistik, znj. V. e ka vlerësuar pozitivisht.

Znj. Sh. B. , Soliste Lirike, në bazë të programacionit artistik sipas kalendarit të shfaqjeve të miratuara nga Bordi Artistiko-Kulturor i TKOBAP për Premierën Grand Gala, ka patur rolin e “Mercedes” me ndarjen e planit të punë. Pasi është një rol i interpretuar prej saj në Operan “Carmen” në të gjitha shfaqjet e vëna nga TKOBAP në vitin 2018.

Për situatën e ndodhur në datë 24.02.2023 në ambientet e institucionit të TKOBAP, është mbajtur procesverbali bashkëlidhur.

Takimi i mbajtur më datë 29.03.2023, është mbajtur në kuadër të procedurës së ndjekur për procedimin disiplinor ndaj znj.Sh. B (B.) dhe jo në kuadër të një hetimi administrativ. Procedura e shqyrtimit të procedurës disiplinore në këtë takim ka garantuar të drejtën e znj.Sh. për t’u dëgjuar, mbrojtur, për të parashtruar fakte dhe prova. Ndër të tjera ajo çfarë do të diskutohej në takim do të

përcaktonte edhe vijimin e marrëdhënies së punës për znj.Sh.. Në bazë të pikës 4, të nenit 181 të Kodit të Punës parashikohet: “Zgjidhja e kontratës së punës, nga punëdhënësi, për përfaqësuesit e organizatës sindikale, pa pëlqimin e kësaj organizate, është e pavlefshme”. znj. Sh. B. (B), nuk është përfaqësuese, por anëtare e Sindikatës dhe kjo është arsyeja pse nuk është marrë pëlqimi i Sindikatës nga ana e TKOBAP-së.

Në takimin e zhvilluar më datë 29.03.2023 nuk mund të komunikohet një vendim, i cili nuk ishte marrë akoma dhe nuk kishte hyrë në fuqi. Në takim znj.Sh. i është bërë e ditur se çfarë u diskutua do të relatohej pranë Drejtorit të Përgjithshëm. znj. V. R. është thirrur në mbledhje nga vetë avokatja znj. B.C dhe është pyetur nga këto të fundit deri në fund të takimit mbi ngjarjet e ndodhura që përfshinin znj. Sh., znj.A. dhe znj.V. .

Pretendimet e ankueses se, aftësia e saj profesionale nëpërkëmbet për shkak të mllëfit të brendshëm që titullarja ka patur ndaj saj qysh në kohën që ka qenë drejtore artistike, janë akuza të pabaza, pasi znj. B. ka vijuar normalisht punën e saj me kërkesat që ka një institucion si TKOBAP edhe pas kallëzimeve penale që ajo ndërmori për ish-Drejtorin e Përgjithshëm dhe Drejtorin Artistik të asaj kohe znj.V. , si dhe etiketimeve dhe shprehjeve të thëna në zhargon popullor kundrejt Drejtorit të Përgjithshëm aktual dhe punonjësve të TKOBAP nga avokati i znj. B. .

Sa i përket kohës kur, znj.A. V. ka marrë mandatin e Drejtorit të Përgjithshëm të TKOBAP-së mund të themi se edhe pse znj.B. e përmend një situatë kur asaj iu hoqën dy ditë punë, pas relativitetit që iu bë Drejtorit të Përgjithshëm, ky i fundit nxori urdhrin nr.860/2 prot datë 05.10.2022 për pushimin e procedimit disiplinor për znj.Sh.B (B) si dhe kompesimin e ditëve të punës.

Nëse shohim renditjen kronologjike të *e-maileve* dhe shkresave, ka raste kur pikërisht drejtori artistik e i përgjithshëm nuk janë trajtuar me respekt, por pavarësisht kësaj është vazhduar puna me objektivitetin e vetëm të realizimit me sukses të shfaqjeve. Drejtori i Përgjithshëm znj. V. ka vendosur drejtësi referuar fakteve dhe rrethanave ashtu si në rastin e kompesimit të ditëve të punës duke bërë “mea culpa” me punëmarrësin.

Sa i përket ngjarjes së fundit të datës 24.02.2023, ka patur një agravim të situatës duke precipituar në fyerje dhe kërcënime me fjalor aspak qytetar, madje janë bërë fyerje nga bashkëshorti i znj. B. (i thirrur nga znj.B. i cili qëndronte në hyrje të institucionit) kundrejt punonjësës e cila kujdeset për marketingun e shfaqjes znj. Gj. për të përfunduar të dyja në komisariat, si rrallë mund të ndodh në një institucion arti. Situata e përmbledhur është si më poshtë:

Bazuar në vendimin e Bordit Artistik nr.53 prot datë 09.12.2022 ishte planifikuar që në skenën e TKOBAP të vendosej Opereta “Karnavalet e Korçës”, konkretisht në datat 25, 26, 27 dhe 27 Shkurt 2023.

Në datën 24.02.2023 rreth orës 18.50 në korridorin e katit të parë, znj. B. ka ndaluar specialisten e marketingut znj. V. R. , për ta pyetur në lidhje me videon e publikuar në faqen zyrtare të TKOBAP për promovimin e Operetës “Karnavalet e Korçës”. Solistja pretendonte në fillim se dukej sikur ishte në video si kor, ndërkohë që ishte soliste dhe më pas me pretendimin “më keni nxjerrë vetëm

3 sekonda” duke ofenduar specialisten znj.V. R. me fjalë jo etike. Specialistja tjetër e ndodhur aty, znj. P.Y , ka njoftuar përgjegjësen e marketingut znj. A.Gj. , lidhur me debatin midis znj. B. dhe znj. R., dhe znj. A.Gj. zbret menjëherë nga zyra e saj dhe shkon në katin e parë dhe i thotë znj. B. që “...çfardolloj problematike që të kesh me vajzat e marketingut duhet të drejtohesh tek unë.....dhe që askush nuk ka të drejtë të ofendojë punonjëset apo ta marrë me vete në zyrë për ta kritikuar...”. znj. B. ka vijuar me pretendimin se, dikush duhet të ketë ndikuar në përzgjedhjen e videos së publikuar duke iu drejtuar znj.Gj: “...me mua matu mirë se nuk më njeh” duke vijuar me kërcënime se do t’ju hedh në gjyq, do t’ju heq nga puna etj.

Pasi agravohet situata, thirret roja i institucionit për të qetësuar sadopak punonjësen dhe më pas kur situata po bëhej e nxehtë lajmërohet Komisarati i Policisë Nr.1 Tiranë, ku punonjëset A.Gj. dhe znj. B. bënë denoncimet/deklaratat e tyre mbi këtë ngjarje.

Në kohën e nxjerrjes së urdhrin nr.40 datë 04.04.2023 për znj. B. nuk ka patur masa disiplinore në fuqi. Në zbatim të Kodit të punës, nenit 37, Rregullores së Brendshme dhe Kontratës kolektive është ndjekur procedura nga punëdhënësi duke i garantuar të drejtën punëmarrësit për tu dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova brenda një afati të arsyeshëm.

TKOBAP i ka vendosur të gjithë dokumentacionin në dispozicion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë kur ankuesja ka paraqitur ankesat e saj. Në lidhje me znj. B. , është kërkuar informacion dhe është vendosur në dispozicion i gjithë informacioni dhe dokumentacioni, institucioneve : Ministrisë së Kulturës, Sindikatës së Pavarur të Artistëve të Shqipërisë, Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale e Qakut Tiranë.

TKOBAP informon se, pozicioni i punës i mbajtur nga ankuesja nuk është plotësuar me punonjës tjetër dhe vendi rezulton vakant dhe se pranë këtij institucioni nuk është depozituar ndonjë njoftim nga gjykata në lidhje me largimin nga puna të ankuseses.

3. Me *e-mailin*, e datës 09.08.2023, pala ankuese ka depozituar kundërshtimet e saj në lidhje deklarimet dhe materialet e paraqitura në cilësinë e provës nga ana e TKOBAP.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet se: “*Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar*” dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanave të çështjes, Komisioneri me shkresën nr. 860/5 prot datë 25.09.2023, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 04.10.2023, ora 10:00.

Me *e-mail-in* e datës 29.09.2023 nga ana e TKOBAP është kërkuar shtyrja e seancës dëgjimore për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë. Për të mundësuar pjesëmarrjen e palëve të përfshira në këtë procedurë administrative në seancën dëgjimore, Komisioneri shtyu seancën dëgjimore në datën 11.10.2023 në ora 12:30.

Seanca dëgjimore e datës 11.10.2023 u zhvillua me pjesmarrjen e ankueses znj.Sh.B (B) dhe përfaqësuesit të saj, Av. E.D, pajisur me licencë nr.4033 dhe TKOBAP, përfaqësuar nga znj. M. B, me detyrë juriste dhe znj. A.Gj. , me detyrë përgjegjës shërbimesh/marketingu, sipas autorizimit me nr.1200 prot., datë 11.10.2023.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me Komisionerin.

Gjatë seancës dëgjimore, Komisioneri i la detyrë TKOBAP, që të depozitonte kopje të pamjeve filmike të ambienteve ku pretendohet se është zhvilluar ngjarja e ndodhur ne datën 24.02.2023, për të cilën ndaj znj. Sh.B (B) është vendosur ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës, kopje të procedurës së ndjekur për trajtimin e ankesave për diskriminim që ankuesja pretendon se ka paraqitur, dhe vlerësime pune të ankueses.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, në datën 17.10.2023, nëpërmjet disa *e-maileve* ankuesja ka depozituar prova shtesë, të cilat janë administruar në dosje. Ndërsa me anë të *e-mailit* datë 30.10.2023, pala ankuese ka depozituar kundërshtime në lidhje me pretendimet e TKOBAP gjatë seancës dëgjimore të datës 11.10.2023.
6. Me shkresën nr. 860/7 prot datë 15.11.2023, Komisioneri i komunikoi kundërshtimet dhe aktet shtesë të depozituara nga pala ankuese në vijim të seancës dëgjimore. Nëpërmjet kësaj shkrese, TKOBAP, iu kërkua që të vendoste në dispozicion aktet e lëna si detyrë gjatë seancës dëgjimore. Me shkresën nr.919/4 prot., datë 30.11.2023, TKOBAP, ka kthyer përgjigje duke parashtruar ndër të tjera se:

Provat e reja që janë depozituar nga pala ankuese janë prova me anë të cilave pala kërkon të mbështesë të njëjtat pretendime, pretendime të cilat TKOBAP i kundërshton nëpërmjet të njëjtave prova që ka depozituar me parë dhe me provat e depozituara nga vet znj. Sh.B.

Znj. Sh.B nuk është trajtuar ndryshe nga kolegët e tjerë sipas pretendimeve të palës ankuese. Rolet për të gjithë solistët nuk përzgjidhen nga ata vetë, por nga Drejtoria e Operas dhe Filarmonisë, nëpërmjetë audicioneve.

Pas përfundimit të operetës “Karnavalet”, Drejtori i Përgjithshëm i TKOBAP ka vlerësuar të gjithë solistët pjesëmarrës sipas procesverbalit të mbajtur në takim in e datës 02.03.2023. TKOBAP, thekson se, zgjidhja e kontratës për znj. B. nuk ka ardhur si pasojë e performancave artistike të saj ndër vite. Ndërsa përsa i përket procedimit disiplinor nisur me shkresën nr.860 prot., datë 23.09.2023⁴, ai nuk përfundoi me një vendim për dhënien e masës disiplinore, pasi në zbatim të praktikës së ndjekur (takimi është mbajtur pasi opera “Cavaleria Rusticana” përfundoi)

⁴ Data është vendosur sipas citimit në shkresën e TKOBAP, por që në fakt viti është lapsus, pasi shkresa e cituar ka datën 23.09.2022 dhe jo 23.09.2023.

nuk rezultoi e bazuar dhënia e një mase të tillë bazuar në prova dhe fakte. Kjo e fundit vërtetohet se institucioni ka vepruar në bazë dhe për zbatim të legjislacionit në fuqi.

Në shkresë jepen statistika të paprovuara, duke cituar “...nuk i keni kthyer përgjigje mbi 70 % të ankesave” apo “Nga këto 9 kërkesa që unë i kam drejtuar institucionit, ju i jeni përgjigjur vetëm dy shkresave të mia”, “4.5 sekonda për artistët e tjerë”. Nuk janë depozituar këto ankesa dhe shkresa në mënyrë që TKOBAP të provojë me fakte dhe më pas të shprehet mbi to.

Bashkëlidhur kësaj shkrese janë dërguar kopje të pamjeve filmike të ngjarjes së ndodhur në datën 24.02.2023.

7. Me shkresën nr.860/9 prot., datë 07.12.2023, Komisioneri i komunikoi ankueses shkresën nr. 919/4 prot., datë 30.11.2023 të TKOBAP dhe kopje të CD me pamjet filmike të depozituar nga subjekti.
8. Në datën 15.12.2023 (administruar pranë Komisionerit me nr. 860/10 prot), pala ankuese ka depozituar kundërshtimet e saj në lidhje me provat e paraqitura nga TKOBAP, nëpërmjet shkresës së sipërcituar. Ndër të tjera pala ankuese pretendon se:

TKOBAP është jashtë afatit ligjor të paraqitjes së provave të pretenduara dhe si e tillë provat e paraqitura bashkë me kthimin e përgjigjes nuk duhen pranuar. Pranimi i tyre nga ana e Komisionerit përbën shkelje procedurale, që tregon njëanshmëri të procesit hetimor administrativ. Shkresa e dërguar nga Komisioneri në datën 15.11.2023 është një vendim administrativ i institucionit për t'i lënë 7 ditë kohë dhe jo një akt i thjeshtë që nuk sjell pasoja. Në kuptim të nenit 53 dhe 54 të Kodit të Procedurës administrative, vendimi i Komisionerit i datës 15.11.2023 është një vendim që sjell pasoja.

Paraqitja e pamjeve filmike vetëm për katin e tretë, pa ato të katit të parë, ku ka ndodhur ngjarja, e bëjnë provën gjysmake. Për të kuptuar rastin në fjalë, duhej që pamjet filmike të jenë të plota, nga kati i parë, i dytë dhe i tretë. Pamjet filmike nuk tregojnë asnjë lidhur me mosdiskriminimin, ashtu siç neni 82/2 parashikon, prandaj kjo nuk përbën provë thelbësore për çështjen. Këto pamje tregojnë se ankuesja nuk ka ushtruar dhunë dhe as ka fyer njëri, as ka kërcënuar A. Gj. Edhe pse këto pamje të regjistruara nga kamera, janë në favorin e ankueses, ato nuk duhet ti bashkohen analizës së ankesës. Duhet që prova të jetë e plotë dhe jo gjysëm.

- *Në lidhje me pretendimin e palës ankuese mospranimin e provave të provave të paraqitura bashkë me kthimin e përgjigjes të TKOBAP-së realizuar me shkresën nr.919/4 prot datë 30.11.2023.*

Pala ankuese pretendon se parashtrimet dhe prova CD e depozituar nga TKOBAP me anë të shkresës nr.919/4 prot datë 30.11.2023, nuk duhet të pranohen pasi janë paraqitur jashtë afatit

ligjor të paraqitjes së provave të përcaktuar në shkresën nr. 860/7 prot datë 15.11.2023, të Komisionerit. Sipas palës ankuese, pranimi i tyre vjen në kundërshtim me Koditn e Procedurës Administrative, me rsyetimin në kuptim të neneve 53⁵ dhe 54⁶ të këtij Kodi, shkresa nr. 860/7 prot datë 15.11.2023 e Komisionerit, është një vendim administrativ që sjell pasoja.

Rezulton se, me shkresën nr. 860/7 prot datë 15.11.2023, Komisioneri, ndër të tjera i ka kërkuar TKOBAP, paraqitjen e akteve dhe provave, nevoja për të cilat rezultoi gjatë seancës dëgjimore. Në këtë shkresë, Komisioneri kishte vendosur si afat për kthimin e përgjigjes, 7 ditë nga marrja dijani për shkresën. TKOBAP, ktheu përgjigje në lidhje me sa ishte kërkuar, nëpërmjet shkresës nr.919/4 prot., datë 30.11.2023.

Komisioneri vlerëson se, në referim të nenit 53 të Kodit të Procedurave Administrative, afati prej 7 ditësh i vendosur në shkresën nr.860/7 prot datë 15.11.2023 të Komisionerit, nuk është një afat i përcaktuar në ligj ose aktet nënligjore, por një afat i caktuar nga ana e organit publik, në rastin konkret, Komisionerit.

Bazuar në parimin e objektivitetit, parashikuar nga neni 14⁷, parimin e hetimit kryesisht, parashikuar nga neni 77⁸ dhe nenin 53, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri

⁵ Neni 53 “Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedural”, Kodi i Procedurave Administrative parashikon: 1. Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim “afatet procedurale”, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore. 2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. 3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”

⁶ Neni 54 “Rivendosja në afat”, Kodi i Procedurave Administrative, parashikon: 1. Përveçse kur ndalohet shprehimisht me ligj, pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv. 2. Rivendosja në afat mund të kërkohej: a) për afatet e përcaktuara për paraqitjen e kërkesës fillestare; b) në lidhje me afatet për kryerjen e veprimeve gjatë procedurës administrative; c) për afatet për paraqitjen e mjeteve të ankimit; si dhe ç) për çdo afat tjetër në dëm të palës. 3. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet kryer edhe veprimi procedural, për të cilin pala ka humbur afatin për shkaqe të arsyeshme. 4. Afati 1-vjeçar, i përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e forcës madhore.”

⁷ Neni 14 “Parimi i objektivitetit”, Kodi i Procedurave Administrative, parashikon: “Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.”

⁸ Neni 77 “Parimi i hetimit kryesisht”, Kodi i Procedurave Administrative, parashikon” : “ 1. Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.....”

vlereson se, nuk ekziton ndonjë pengesë ligjore procedurale për pranimin e provës CD dhe parashtrimeve të depozituara nga TKOBAP.

Në lidhje me pretendimin tjetër të palës ankuese se, pamjet filmike të depozituara nuk janë të plota pasi nuk përfshijnë pamjet e katit të parë, Komisioneri vlerëson se, ky fakt nuk mund të shërbejë si arsye për mospranimin e provës. Pala ankuese nuk i kundërshton për vërtetësi pamjet filmike që shfaqen në CD e depozituar në cilësinë e provës të depozituara nga TKOBAP.

Komisioneri përfundimisht vlerëson se, pamjet filmike të depozituara nga TKOBAP do të vlerësohen në harmoni me të gjitha faktet dhe provat e tjera të administruara gjatë procedurës së shqyrtimit.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “Diskriminimit i drejtpërdrejtë”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “Diskriminimit të tërthortë” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo

trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Në Kreun II, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD, në nenin 12/1/c, përcakton se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”.*

Në nenin 9, pika 1, 2, dhe pika 5, germa “c”, të Kodit të punës përcaktohet:

“1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

3. Ndalimi i diskriminimit, i përcaktuar nga ky Kod, nuk zbatohet nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

5. Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesenn në të drejtën për punësim;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;

- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesja i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj për punësim dhe profesion, në lidhje me momentet e pretenduara në ankesën e paraqitur. Nëse konstatohet se ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, atëherë do të vijohet me analizën, nëse ky trajtim të cilit i është nënshtruar ankuesja ka ardhur apo jo si rezultat i shkaqeve të pretenduara, të cilat duhet gjithashtu të gëzojnë mbrojtje nga ligji. Në rast se nuk konstatohet ndonjë trajtim i padrejtë dhe i pafavorshëm, Komisioneri nuk do të vijojë me pjesën e dytë të vlerësimit, pasi elementët e sipërcituar duhet të plotësohen njëkohësisht dhe mungesa e trajtimit të padrejtë të pabarabartë dhe të pafavorshëm, do të rrëzonte pretendimin për diskriminim pa kaluar në vlerësimin e ekzistencës ose jo të elementë të tjerë.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja znj. Sh. B. (B), e datëlindjes 10.05.1977, është banuese në qytetin e Tiranës. Në kohën që pretendohet se është diskriminuar ka qenë në marrëdhënie pune pranë institucionit të Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe Asambliit Popullor ku ka mbajtur pozicionin e punës Soliste e Dytë Lirike. Ankuesja ka filluar punë pranë TKOBAP në datën 01.10.1999, fakt ky që rezultoi i provuar nga Libreza e Punës.

Referuar dokumentacionit të administruar, konkretisht Kontratave Individuale të Punës rezultoi që ankueses i është rinovuar kontrata individuale e punës për pozicionin e punës Soliste e Dytë Lirike në mënyrë periodike me afate 2 vjeçare dhe ajo ka mbajtur pozicionin e Solistes së Dytë Lirike. Kontrata e fundit individuale e lidhur midis ankueses dhe TKOBAP, rezultoi të jetë nënshkruar në datën 11.07.2022 me Nr.225/2 prot. Rezultoi gjithashtu se, ankuesja është anëtare e Sindikatës së pavarur të Artistëve të Shqipërisë.

Në datën 06.12.2017, rezultoi të jetë nënshkruar midis TKOBAP dhe Sindikatës së Pavarur të Artistëve dhe Punonjësve të tjerë të TKOBAP, Kontrata Kolektive e punës, e cila i shtrin efektet mbi të gjithë punonjësit dhe është lidhur për një afat të pacaktuar.

Rezultoi se, midis Ministrisë së Kulturës dhe Sindikatës së Pavarur të Artistëve të Shqipërisë, është nënshkruar në datën 02.06.2020, Kontrata Kolektive e Punës, e cila ka si fushë zbatimi rregullimin e marrëdhënieve të punës midis institucioneve publike të artit dhe kulturës dhe punëmarrësve artistë që janë anëtarë të Sindikatës së Pavarur të Artistëve të Shqipërisë, në fushën e artit dhe kulturës në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 3, të Kontratës Kolektive të Punës, afati i saj është 3 vjet.

Nga aktet e administruara rezulton se, që në fillimet e saj në marrëdhëniet e punës midis ankueses dhe znj. V. , në atë kohë në funksionin e Drejtores Artistike, në varësi të të cilës ka qenë ankuesja si Soliste e Dytë Lirike, ka patur mosmarrëveshje. Konkretisht me urdhrin nr.2800, datë 11.12.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm TKOBAP, ka vendosur si masë disiplinore ndaj ankueses, për moszbatim të urdhrave dhe instruksioneve të dhëna nga eprori direkt, ndërsa me urdhrin nr.2873 datë 29.12.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të TKOBAP, ndaj ankueses është vendosur një tjetër masë disiplinore, vërejtje me shkrim, për arsye të sjelljes jo etike në marrëdhënie me eprorin. Në të dyja rastet, eprori direkt i ankueses ka qenë znj. V. , Drejtore Artistike.

Në vijimësi, nëpërmjet një sërë ankesash, ankuesja në mënyrë të vazhdueshme ka paraqitur ankesa tek Drejtori i Përgjithshëm i TKOBAP, në atë kohë znj. Z.Ç , duke pretenduar se znj. V. si Drejtore Artistike ka treguar njëanshmëri në vlerësimin e saj si dhe padrejtësitë që i ka bërë në mënyrë të përsëritur për ta mënjanuar nga aktivitetet e organizuara nga TKOBAP. Sipas ankueses, aftësia e saj profesionale është cenuar për shkak të mllëfit të brendshëm dhe personal të znj. V. , fillimisht në detyrën e Drejtores Artistike dhe më pas si Drejtore e Përgjithshme e TKOBAP. Rezulton gjithashtu e provuar si nga deklarimet e palëve ashtu edhe aktet e administruara se, ankuesja në nëntor 2021 ka bërë kallëzim penal, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër znj. A.V. , me detyrë Drejtore Artistike dhe znj. Z.Ç , Drejtore e Përgjithshme e TKOBAP, duke pretenduar se kanë shpërdoruar detyrën, në lidhje me shpërndarjen e roleve në institucion.

Me urdhrin Nr.40, datë 04.04.2023 (Nr.343/2 prot datë 04.04.2023) të Drejtorit të Përgjithshëm të TKOBAP “Për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës për shkaqe të justifikuara për Solisten e Dytë Lirike pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë znj.Sh. B” është urdhëruar: *“I. Ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës për shkaqe të justifikuara të Solistes së Dytë Lirike, znj. Sh.B.II. Dorëzimin e dokumentacionit, të mjeteve të punës në inventar dhe dorëzimin e plotë të detyrës brenda datës 04/04/2023.III. Marrëdhënia financiare ndërpritet në ditën e njoftimit të këtij urdhëri.....”*. Rezulton se ankuesja ka marrë dijeni për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në datën 4.04.2023, sipas shënimit të vendosur në kopjen e urdhrin të sipërcituar.

Në lidhje me zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme të Kontratës së Punës, pala ankuese ka paraqitur para TKOBAP kërkesën ankimore, administruar me nr.488 prot datë 10.05.2023, nëpërmjet të cilës kërkon shfuqizimin e urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe rikthimin e saj në detyrë. Nëpërmjet shkresës nr.488/1 prot datë 02.06.2023, TKOBAP, i ka kthyer përgjigje kësaj kërkesë ankimore.

Në datën 25.05.2023, është mbajtur një takim në ambientet e TKOBAP, midis përfaqësuesve të këtij të fundit dhe përfaqësuesve të Sindikatës së Pavarur të Artistëve të Shqipërisë dhe Sindikatës në TKOBAP-së për Ansamblin Popullor.

Me shkresën Nr.13/5 prot datë 22.06.2023, protokolluar pranë TKOBAP me nr.567/2 prot datë 26.06.2023, Sindikata e Pavarur e Artistëve të Shqipërisë, i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Aftësimit, Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Tiranë, Zyrës së Ndërmjetësimit dhe Pajtimit Tiranë, me një kërkesë për ndërmjetësim dhe pajtim. Në lidhje me këtë kërkesë TKOBAP është vendosur për dijeni. Në këtë kërkesë, parashtrohet se, pasi janë njohur me praktikën e ndjekur nga institucioni, nuk faktehet dhuna verbale nga ana e znj. B. për një masë të tillë largimi të menjëhershëm nga puna, duke kërkuar nga këto institucione mundësinë për ndërmjetësim dhe pajtim mes znj. B. dhe znj. V., me qëllim rikthimin e znj. B. në detyrë.

Me shkresën nr.567/3 prot datë 06.07.2023, TKOBAP, i ka kthyer përgjigje Sindikatës në lidhje me kërkesën për ndërmjetësim dhe pajtim, duke u shprehur se, janë zbatuar të gjitha procedurat dhe janë organet kompetente të cilat gjykojnë mbi bazueshmërinë ose jo. Në këtë përgjigje theksohet gjithashtu se, seancat e ndërmjetësimit si rregull kryehen përpara marrjes së vendimit, me kërkesë të punonjësit ose përfaqësuesit të tij avokat, ndërmjetës dhe me praninë e sindikatës në rastet e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi, duke u shprehur se nuk mund të pranohet kërkesën për ndërmjetësim dhe pajtim.

Ankuesja ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi me nr.144 Regj., datë 14.07.2023, kundër TKOBAP, me pretendimin se është diskriminuar në të drejtën për punësim dhe profesion . Ankuesja pretendon se, është diskriminuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë, si gjatë ecurisë së marrëdhënies së punës, ashtu edhe në momentin e ndërprerjes së kësaj marrëdhënie. Ankuesja pretendon se është diskriminuar gjatë marrëdhënies së punësimit duke u trajtuar në mënyrë diskriminuese, në lidhje me bërjen e audicioneve artistike pa komision vlerësimi, eliminimin e ankueses pa komision, shpifjet ndaj ankueses duke thënë se është e paaftë profesionalisht, ushtrimin e presionit psikologjik, fakt ky që është i dukshëm sepse ankuesja jo vetëm që është ankuar për të por edhe e-maillet dhe procesverbalet e tregojnë këtë gjë, si dhe është vepruar në kundërshtim me Kodin e Punës, kur ndaj saj është marrë masë administrative e heqjes së dy ditëve punë, pa një vendim administrativ. Në lidhje me momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ankuesja pretendon se është diskriminuar, pasi zgjidhja e kontratës së punës është bërë në kundërshtim me Kodin e Punës, Kontratën Individuale të Punës, Kontratën Kolektive të Punës dhe Rregulloren e Institucionit.

1. Në lidhje me pretendimin për diskriminim gjatë marrëdhënies së punësimit.

Ankuesja pretendon se është diskriminuar gjatë marrëdhënies së punësimit duke u trajtuar në mënyrë diskriminuese, në lidhje me bërjen e audicioneve artistike pa komision vlerësimi, eliminimin e ankueses pa komision, shpifjet ndaj ankueses duke thënë se është e paaftë profesionalisht, ushtrimin e presionit psikologjik, fakt ky që është i dukshëm sepse ankuesja jo vetëm që është ankuar për të por edhe *e-maillet* dhe procesverbalet e tregojnë këtë gjë, si dhe është

vepruar në kundërshtim me Kodin e Punës, kur ndaj saj është marrë masë administrative e heqjes së dy ditëve punë, pa një vendim administrativ.

Ankuesja ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi në datën 18.07.2023, ndërsa pretendimet për diskriminim të ankuses, bazuar në parashtrimet e paraqitura prej saj, datojnë nga viti 2019 deri në datën 04.04.2023, kur ankueses i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës. Në lidhje me momentet e pretenduara si diskriminuese, gjatë ecurisë së marrëdhënies së punës, ankuesja ka identifikuar si situata të veçanta diskriminuese:

- audicionin e zhvilluar në tetor 2019 për veprën artistike “Cavaleria Rusticana. ”;
- duke pretenduar se znj.V. , në funksionin e Drejtores Artistike i mohonte daljen në skenë dhe ishte skualifikuar pa komision, ankuesja është ankuar disa herë tek Drejtori i Përgjithshëm i TKOBAP, duke denoncuar diskriminimin që i bëhej në mënyrë të vazhdueshme nga znj.V. (ankesë me e-mail datë 11.11.2019, ankesë nr.518 prot datë 13.09.2019, nr. 406 prot datë 06.10.2019, nr. 636 prot datë 06.11.2019, nr.695 prot datë 25.11.2019, nr. 40 prot datë 23.01.2020);
- propozimin për ulje nga kategoria me nr. 225 prot datë 03.07.2020, për të cilin ankuesja deklaroi se ka marrë dënim në datën 27.09.2021 dhe ka paraqitur ankim në datën 30.11.2021 (ankimi protokolluar pranë TKOBAP në datën 05.10.2021);
- rastin e ndodhur më datë 15.09.2021 dhe 16.09.2021 për sa i përket moslejimit të saj për të marrë pjesë në “Premierën Grand Gala të Inagurimit të TKOBAP-së”;
- procedimin disiplinor për mosmarrje pjesë në prova dhe heqja e dy ditëve punë, në muajin tetor 2022;
- mosshfaqjen e emrit ose shkruajtjen gabim të emrit të saj në banerat e shfaqeve të muajve shtator dhe dhjetor 2022;
- gjatë promovimit të shfaqes Karnavalet e Korçës, për ankuesen është lënë në dispozicion vetëm 1 sekondë nga e gjithë shfaqja e shfaqur në Facebook, nga 4 sekonda që kishin në dispozicion kolegët e saj;

Komisioneri çmon se, në radhë të parë duhet vlerësuar nëse të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, janë brenda afatave të parashikuara nga ligji për marrjen e tyre në shqyrtim nga A. e institucionit. Për të bërë këtë vlerësim i referohemi, nenit 33, pika 4, germa “dh” të LMD-së, ku përcaktohet: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse:dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dënim për sjelljen diskriminuese.”*

Bazuar në pretendimet e paraqitura, si dhe në referim të nenit 33, pika 4, germa “dh”, të LMD, Komisioneri arrin në përfundimin se, pretendimet në lidhje me audicionin e zhvilluar në tetor 2019 për veprën artistike “Cavaleria Rusticana ”; pretendimet në lidhje me ankesat e paraqitura për mohimin për të dalë në skenë, skualifikimin pa komision, duke denoncuar diskriminimin që i bëhej në mënyrë të vazhdueshme nga znj.V. (ankesë me e-mail datë 11.11.2019, ankesë nr.518 prot datë 13.09.2019, nr. 406 prot datë 06.10.2019, nr. 636 prot datë 06.11.2019, nr.695 prot datë 25.11.2019, nr. 40 prot datë 23.01.2020); pretendimet në lidhje me propozimin për ulje nga

kategoria me nr. 225 prot datë 03.07.2020, për të cilin ankuesja deklaroi se ka marrë dëgjimin në datën 27.09.2021 dhe ka paraqitur ankim në datën 30.11.2021 (ankimi protokolluar pranë TKOBAP në datën 05.10.2021), nuk mund të merren në shqyrtim, pasi janë paraqitur jashtë afateve ligjore, të parashikuara në dispozitën e mësipërme ligjore.

- Në lidhje me rastin e ndodhur më datë 15.09.2021 dhe 16.09.2021, për sa i përket mos lejimit të ankueses për të marrë pjesë në “Premierën Grand Gala të Inagurimit të TKOBAP-së”.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara rezultoi se, ankuesja nuk ka marrë pjesë në “Premierën Grand Gala të Inagurimit të TKOBAP-së” të zhvilluar në datat 15.09.2021 dhe 16.09.2021. Ankuesja pretendon se nuk është lejuar nga znj. V. , në atë kohë në detyrën e Drejtores Artistike për të qenë pjesë e këtij eventit shumë të rëndësishëm për të gjithë artistët e TKOBAP.

TKOBAP, prapësoi pretendimin e ankueses se ajo nuk ishte lejuar për të marrë pjesë në Galanë e Inagurimit të TKOBAP-së, pasi ankuesja ka patur rolin “Mercedes”, një rol ky i interpretuar prej ankueses në Operan “Carmen” në të gjitha shfaqjet e vëna nga TKOBAP gjatë vitit 2018. Sipas TKOBAP, ankuesja nuk ka pranuar të interpretojë rolin e “Mercedes” me arsyetimin “fyerje e figurës artistike”. Mosprezenca e ankueses në Grand Gala, ka qenë zgjedhje e ankueses pa asnjë pasojë ekonomike ose masë disiplinore për moskryerje të rolit.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, ankuesja pranon se ka qenë e përfshirë sipas programacionit të përgatitur nga znj.V. , për natën e parë të Galasë, që ishte nata me protokoll, në Operan Carmen, por si shoqëruese e Solistes K., ku sipas saj do të kishte vetëm një pasash duke shoqëruar solisten kryesore me një “tra-la-la”. Gjendur përpara këtij propozimi, ajo deklaroi se e ka refuzuar të ketë rolin e shoqërueses në këtë event duke kërkuar që t’i lihej hapësirë për interpretimin e një materiali solo sikurse kolegja në fjalë. Ankuesja pretendon se, ky vlerësim i bërë nga znj.V. , ishte ofendues për atë dhe nënvlerësues, duke patur parasysh eksperiencën, vitet e punës, kontributin në skenë dhe vlerat e saj si artiste. Sipas ankueses të gjithë kolegëve ju ishte lënë hapësirë interpretimi dhe përzgjedhjen e materialit, kurse asaj jo. Sipas ankueses ky përbën një diskriminim të hapur që i është bërë asaj në raport me kolegët e tjerë.

Ankuesja deklaroi se, në datën e dytë, që ishte natë e hapur për publikun, znj.V. kishte planifikuar që për Arjen e Mrikës, të konkuronin 4 soliste, përfshirë dhe vetë ankuesen. Materiali u përgatit nga të 4 solistët, u bënë prova me orkestër, deri 2 ditë përpara se të vinte dirigjenti i huaj (M.A). Ankuesja deklaroi se ka qenë në pritje të vlersimit të Drejtoreshës Artistike, për Arjen e Mrikës duke reaguar me *e-maile*, përgjegjësit të sektorit, drejtoreshës artistike dhe asaj të përgjithshme, pasi nuk dinte pozicionin e saj, por përsëri nuk mori përgjigje. Materiali Arja e Mrikës, iu caktua solistes R.L, kurse dy koleget e tjera dhe ankuesja, ngelën bosh. Sipas ankueses, dy koleget e tjera ju dha material tjetër, nga Drejtoresha Artistike, për të dalë në skenën e Galasë, kurse ankueses jo, duke përjashtuar, pa asnjë arsye nga Galaja.

Pala ankuese ka depozituar në cilësinë e provës dy *e-maile* të datës 09.09.2021. Një *e-mail* që znj.I. i ka përcjellë znj.V. , Drejtores Artistike dhe znj. Z.Ç nëpërmjet të cilit kërkohet informacion, nisur nga interesimi i bërë nga ankuesja pranë saj, nëse znj. B. do të ishte pjesë provave me dirigjentin në lidhje me Ariozen e Mrikës. E-maili tjetër është dërguar nga ankuesja po të njëjtëve subjekte duke kërkuar informacion se çfarë vendimi ishte marrë për materialin e Galasë, a do të merrte pjesë në Gala, pasi ishte data 09.09.2021, si dhe sa duhet të priste.

Ankesën në lidhje me mospjesmarrjen në Galanë e Inagurimit të TKOBAP, ankuesja e ka bërë prezent, pranë Sindikatës së Pavarur të Artistëve të Shqipërisë. Kjo e fundit i është drejtuar me shkresën nr.513 prot datë 13.09.2021 TKOBAP, duke kërkuar shqyrtimin e ankesave dhe shqetësimin e radhës të shprehur nga ankuesja, si anëtare e kësaj sindikate, që konsistonin në mosaktivizimin e saj të padrejtë në Gala duke mos u lejuar të kryeje punën e vet. Në përgjigje të kësaj shkrese, ka kthyer përgjigje znj.V. me *e-mailin* e datës 06.10.2021, duke konfirmuar se, ankueses i ishte dhënë roli i “Mercedes” me ndarjen e planit të punës, por ishte refuzuar prej ankueses. Në këtë përgjigje znj.V. thekson se, në bazë të Rregullores së Institucionit, neni 15, pika 1, në lidhje me figurën e Drejtorit Artistik përcaktohet: “Drejtori është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë”. Pra politika e këtij roli në institucion është të marrë vendime artistike dhe drejtoria nuk mund të jetë përgjegjëse për të gjithë artistët që nuk ju përgjigjen objektivave të saj.

Bazuar në faktet dhe rrethanave të çështjes, ku ngrihen pretendime në lidhje me performancën apo nivelin artistik, Komisioneri çmon se është në diskrecionin e strukturave artistike të institucionit të TKOBAP, që të bëjnë vlerësime të kësaj natyre. Komisioneri nuk mund të vlerësojë, në lidhje me nivelin artistik artistëve apo ndarjen e roleve.

Sa më sipër, bazuar në tërësinë e akteve të administruara, korrespondencës së administruar që është mbajtur midis ankueses dhe TKOBAP dhe faktit që ankuesja nuk është përjashtuar plotësisht, pasi sikurse pranohet edhe nga ajo vetë asaj i është caktuar sipas planit të punës roli i “Mercedes” në Operan Carmen” Komisioneri, nuk konstaton elementë të trajtimit të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë të ankueses nga ana e TKOBAP, për sa i përket pretendimin për moslejimin e ankueses për të marrë pjesë në “Premierën Grand Gala të Inagurimit të TKOBAP-së”, të zhvilluar në datat 15 dhe 16 shtator 2021.

- *Në lidhje me procedimin disiplinor për mosmarrje pjesë në prova dhe heqja e dy ditëve punë, në muajin tetor 2022.*

Nga aktet e administruara rezulton se, me shkresën nr. 860 prot datë 23.09.2023, ankuesja është njoftuar për fillimin e një procedimi disiplinor ndaj saj, për mosparaqitje në provat e shfaqes Cavalleria Rusticana” nga ora 10:00 deri në 11:30 e në vijim sipas planit të provave, duke sjellë pasoja të rënda deri në anulimin e tyre, si dhe mosrespektim të parimit të mirëbesimit, drejtësisë

dhe bashkëpunimit me institucionin. Në lidhje me këtë ngjarje rezultoi se ankueses i është bërë ndalesë në pagën e muajit shtator 2022.

Në kuadër të këtij procedimi disiplinor të filluar ndaj ankueses, rezultoi sipas procesverbalit të mbajtur në datën 05.10.2022, protokolluar me nr.860/1 prot, se midis ankueses dhe punëdhënësit TKOBAP, është mbajtur një takim.

Në vijim të takimit të zhvilluar në datën 05.10.2022, Drejtori i Përgjithshëm i TKOBAP, ka nxjerrë vendimin e datës 05.10.2022 (protokolluar me nr.860/2 prot datë 05.10.2022), nëpërmjet të cilit është vendosur: *“ I. Pushimin e çështjes për procedimin disiplinor ndaj solistes Lirike znj.Sh.B për mungesa në provat e operas “Cavalleria Rusticana” pasi referuar procesverbalit të takimit mbi procedimin disiplinor në ngarkim të saj, rezultoi e provuar se solistja lirike ka ekzekutuar provat sipas planit të nxjerrë nga Drejtoria e Operas dhe Filarmonisë”.*

Komisioneri vlerëson se, punëdhënësi, ka të drejtën që të fillojë një procedim disiplinor nëse pretendohet se nga ana e punëmarrësit janë konsumuar veprime ose mosveprime që konsiderohen shkelje në kuadër të marrëdhënieve të punës. Ushtrimi i kësaj të drejte nga ana e një punëdhënësi nuk mund të përbëjë cenim të të drejtave të punëdhënësit.

Sa më sipër, rezultoi se, në përfundim të procedimit disiplinor të filluar ndaj ankueses, punëdhënësi, në rastin konkret TKOBAP ka arritur në përfundim se, ankuesja nuk e kishte konsumuar shkeljen disiplinor të pretenduar dhe procedimi disiplinor ndaj saj është pushuar. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se, ankuesja nuk rezultoi të jetë cenuar në të drejtat e saj si punëmarrëse, si pasojë e procedimit disiplinor të filluar ndaj saj.

Përfundimisht, Komisioneri nuk konstaton elementë të trajtimit të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë të ankueses nga ana e TKOBAP, në lidhje me procedimin disiplinor për mosmarrje pjesë në prova dhe heqja e ditëve të punës, në muajin tetor 2022.

- *Në lidhje me mosshfaqjen e emrit ose shkruajtjen gabim të emrit të saj në banerat e shfaqeve të muajve shtator dhe dhjetor 2022 dhe pretendimet në lidhje me minutazhin e shfaqjes së ankueses gjatë promovimit të shfaqes Karnavalet e Korçës.*

Nga aktet e administruara rezultoi se, në datën 27.12.2022, ankuesja i është drejtuar strukturave drejtuese të TKOBAP, nëpërmjet të cilit “denoncon” punonjësen e marketingut V. , për abuzim të hapur me detyrën. Ndër të tjera, ankuesja shprehet në këtë e-mail se, kjo punonjëse nuk publikon foto të ankueses në faqet zyrtare të institucionit dhe se, kishte konstatuar një ditë më parë se, kjo punonjëse kishte shkruajtur gabim emrin e ankueses në banerin e galasë së fundvitit.

Nga aktet e administruara rezultoi se, në datën 24.02.2023, ankuesja i është drejtuar strukturave drejtuese të TKOBAP, nëpërmjet të cilit “denoncon” një situatë të përsëritur me sektorin e

marketingut, ku figura e saj si artiste Soliste e TOB-it po diskriminohet hapur dhe në mënyrë të pandërprerë. Në këtë *e-mail* ankuesja bën me dije se, në videon e publikuar një ditë më parë nga sektori i marketingut pas provës gjenerale të veprës Karnavalet janë shfaqur sekuenca të të gjithë personazheve apo interpretëve të kësaj vepre duke performuar dhe vetëm ankuesja nuk ka asnjë sekuençë gjatë performancës së saj, por vetëm një fragment sekonde. Ankuesja kërkon që të merren masa urgjente për personin përgjegjës të këtij veprimi që shpërdoron hapur vendin e punës duke i sjellë ankueses dëme të imazhit dhe integritetit të saj si Soliste dhe artiste e institucionit dhe njëkohësisht duke shkelur detyrimet që ka për të rreklamuar punën dhe imazhin e çdo artisti.

Ankuesja pretendon se, të gjitha këto veprime, janë bërë enkas për të dëmtuar imazhin e saj skenik dhe artistik, nuk është se janë bërë pa dijeni të dikujt nga Drejtoria dhe përbëjnë diskriminim ndaj ankueses.

Ankuesja deklaron se, në lidhje me shkrimin e emrit gabim në banerin e galasë së fundvitit, ndaj punonjësës V. R. , është marrë masë disiplinore.

Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 02.03.2023, është zhvilluar një takim në zyrën e drejtorit të përgjithshëm të TKOBAP, ku kanë marrë pjesë solistë dhe pianistë, përfshi edhe ankuesen. referuar këtij procesverbali, çështja e trajtuar në këtë takim ka qenë problematika e vazhdueshme ndërmjet marrëdhënies së sektorit të solistëve me zyrën e marketingut. Ndër të tjera, znj.V. , Drejtore e Përgjithshme, ka theksuar se: “.....Në asnjë nga pikat e kësaj kontrate nuk është shkruajtur që solistët lirikë të TKOBAP-së kanë një marrëdhënie me marketimin, ku i kërkojnë llogari sipas dëshirës, arsyetimeve personale. Marketimi i TKOBAP jep llogari dhe merr konfirmimin nga Drejtori i Përgjithshëm, thënë kjo ne kemi stabilizuar një format në një mbledhje.....me stafin e “Karnavaleve”....., nga ky moment, secili nga solistët që do të ketë kërkesë, ankesë, dëshirë, shkruan *e-mail* te Drejtori i Përgjithshëm, ankohet për një arsye që sipas tij apo saj i duket normale dhe do të marrë përgjigje në bazë të prioritetit që ka dita ime e cila ka një agjendë e cila ska vetëm solistët, ka disa detyra më shumë.....”

Referuar pretendimeve të ankueses, Komisioneri nuk identifikon ndonjë ndikim të rëndësishëm në ushtrimin e të drejtave të ankueses në kuadër të marrëdhënies së saj të punësimit, si pasojë e pretendime të ngritura në lidhje me shkrimin e emrit gabim apo minutazhin e shfaqjes së ankueses në kuadër të promovimit të shfaqes Karnavalet e Korçës. Për më tepër, në lidhje me shkrimin gabim të emrit të ankueses, kjo e fundit pranon se nga ana e punëdhënësit/TKOBAP, është marrë masë disiplinore ndaj punonjësës.

Sa më sipër dhe bazuar në tërësinë e akteve të administruara gjatë procedurës së shqyrtimit, Komisioneri, nuk konstaton elementë të trajtimit të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë të ankueses nga ana e TKOBAP, në lidhje me shkruajtjen gabim të emrit në banerat e galasë së fundvitit 2022 dhe pretendimet në lidhje me minutazhin e shfaqjes së ankueses gjatë promovimit të shfaqes Karnavalet e Korçës,

- Në lidhje me ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës, sipas urdhrin nr.40, datë 04.04.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të TKOBAP-së.

Bazuar në aktet e administruara rezulton se, me shkresën nr.343 prot, datë 24.03.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm “Njoftim për fillimin e procedurës mbi vijim e marrëdhënies suaj të punës”, ankuesja është njoftuar që më datë 29.03.2023 ora 11:00, duhet të paraqitet për takimin që do të bëhet lidhur me fillimin e procedurës mbi vijimin e marrëdhënies e saj të punës, në zbatim të nenit 144, të Kodit të Punës. Në këtë njoftim, motivacioni i pasqyruar për fillimin e procedurës mbi ecurinë e marrëdhënies së punës me ankuesen, sipas nenit 144 të Kodit të Punës, cilësohet si vijon: “Referuar ngjarjes së ndodhur më datë 24.02.2023 në ambientet e Institucionit mes Jush dhe punonjësve; znj. A.Gj. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe znj.V. R. , Specialiste pranë Sektorit të promocionit dhe Imazhit, në kundërshtim të plotë me rregullat e etikës dhe komunikimit që kaloi në fyerje dhe dhunë verbale të ushtruar nga A. juaj ndaj punonjësve të këtij institucioni, ndërkohë që po ushtronin detyrën e tyre funksionale në përcjelljen dhe promovimin e operetës “Karnavalet e Korçës”.

Në datën 29.03.2023, është zhvilluar takimi në lidhje me vijimin e marrëdhënies së punës me ankuesen sipas njoftimit nr.343 prot datë 24.03.2023, fakt ky që është pasqyruar në procesverbalin me nr.343/1 prot datë 29.03.2023. Në këtë takim ankuesja ka marrë pjesë së bashku me mbrojtësin e saj ligjor. Në takim kanë marrë pjesë znj. M.D, Drejtore pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj.A.Gj. , Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve, znj. M.B, Juriste dhe znj. V. R. , Specialiste pranë Sektorit të Promocionit dhe Imazhit.

Në vijim të takimit të zhvilluar në datën 29.03.2023, me vendimin nr.40, datë 04.04.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të TKOBAP, është vendosur ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës me ankuesen për shkaqe të justifikuara. Referuar vendimit për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës me ankuesen, punëdhënësi/TKOBAP-së, arsyeton:

“...vlerësohet se, referuar ngjarjes së ndodhur më datë 24.02.2023 në ambientet e institucionit mes znj.Sh.B dhe punonjësve: znj. A.Gj. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe znj.V. R. , Specialiste pranë Sektorit të Promocionit dhe Imazhit, në kundërshtim të plotë me rregullat e etikës dhe komunikimit që kaloi në fyerje dhe dhunë verbale të ushtruar nga ana juaj ndaj punonjësve ndërkohë që po ushtronin detyrën e tyre funksionale në përcjelljen dhe promovimin e operetës “Karnavalet e Korçës”, në referencë të sa vijon:

1. Moszbatimi i Rregullores së Brendshme të Institucionit të TKOBAP dhe sjellja në kundërshtim me rregullat e etikës”.

Rezulton nga aktet e administruara se, në datën 24.2. 2023, nga ana e znj. M.B, Juriste e TKOBAP është mbajtur Procesverbali “ Incidentit të ndodhur në Teatrin Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor” me Nr.265 prot datë 24.2.2023. Në këtë procesverbal pasqyrohet ndër të tjera

se: “Të premten e datës 24.02.2023, rreth orës 18.50, në korridorin e katit të parë të TKOBAP-së (sheshpushimi përballë derës së prapaskenës), solistja, Sh.B. , ka ndaluar specialisten e marketingut, V. R. , për t’i kërkuar llogari në lidhje me një video të publikuar në faqen zyrtare të medias sociale të TKOBAP-së, Facebook dhe Instagram. Solistja pretendonte se nuk ishte pjesë e videos. Znj. B. e ka ofenduar znj.R. me fjalë si qelbësirë, injorante, debile, budallackë etj.) Pasi znj. R. është ndjerë e prekur nga ofendimet, bashkë me solisten i janë drejtuar një prej dhomave të solistëve që ndodhen në katin e parë.....Gjatë kësaj periudhe që znj.R dhe znj.B. kanë qëndruar në dhomë, specialistja znj. P.Y , ka njoftuar përgjegjësen e shërbimeve, znj.A.Gj. , e cila është përgjegjëse edhe për sektorin e Marketing-ut dhe ndodhej në godinën e TKOB-së. Znj. Gj. ka zbritur menjëherë nga kati i tretë në katin e parë, ku po ndodhte konflikti. Ajo i ka kërkuar znj.B. që “cfarëdolloj problematike të kesh me vajzat e marketingut, duhet të drejtohesh tek mua” dhe që “nuk ka të drejtë as të ofendojë punonjësen apo ta marrë me vete në zyrë për ta kritikuar. Znj. B. ka vijuar me pretendimin se dikush mund të ketë ndikuar në zgjedhjen e videos së publikuar, duke iu drejtuar znj. Gj. se, “me mua matu mirë se nuk më njeh”. Gjithashtu ka vijuar duke kërcënuar se do ta hedhë në gjyq përgjegjësen e sektorit të marketing-ut dhe Drejtorin e Përgjithshëm, si dhe që do të heqë nga puna znj.Gj. Përgjegjësja e Marketing-ut ka vënë në dijeni menjëherë Drejtoreshën e Përgjithshme, znj.A. V.Sipas direktivave të Drejtorit të Përgjithshëm, në institucion ka mbërritur punonjësi i IT-së z.E.B dhe juristja M. B. Znj.Gj. ka shkuar bashkë me punonjësin e IT-së për të hapur kamerat sipas direktivave të Drejtorit të Përgjithshëm ndërsa juristja po vinte. Juristja e institucionit ka kërkuar të takojë punonjëset e marketingut dhe ka takuar solisten znj.Sh.B. , e cila sërish po ju bërtiste vajzave për videon. Pas disa minutash debat, ku znj.B. ka ofenduar të katërta vajzat me fjalë nga më të ndryshmet. Këtu ka agravuar situata dhe znj.M. ka thirrur rojen e institucionit për të qetësuar situatën derisa të dyja palët kanë dalë jashtë institucionit. Në atë moment roja e institucionit ka kontaktuar komisaratin dhe në hyrjen pas TKOBAP-së mbërritën rreth 6-7 oficerë policie. Oficerët kanë shoqëruar në Komisaratin Nr.1 të Tiranës znj.A.Gj. dhe znj.Sh. B. rreth orës 20:00, të së premtes.Pas tyre kanë shkuar edhe juristja e institucionit znj.M.B dhe drejtori i Produksionit, z.H. I, bashkë me dy specialistet e marketingut znj.V. R. dhe znj.P.Y . Në komisarati kanë dhënë dëshminë vetëm znj.Sh. B. dhe znj.A.Gj. , të cilat kanë dalë nga Komisarati rreth orës 22.00”

Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 24.2.2023 nga ana e Specialistit të Sektorit të IT, pasqyrohet se, nga ana e tij janë nxjerrë pamjet filmike nga sistemi cctv i kamerave të instaluar në institucion për datën 24 shkurt 2023, specifikisht pamjet filmike të kamerës së katit të 3-të (sheshpushimi te shkallët nga krahu i hyrjes në zyrat e marketingut) për periudhën nga ora 22:00 deri në orën 21:00. Në këtë procesverbal specialisti i IT, sqaron se, ora që shfaqet në kamera është me diferencë 1 orë e 25 minuta përpara kohës reale, pra ora 21:26 (në video) është në të vërtetë 20:01. Për sa i përket kamerës në katin e parë përpara hyrjes së skenës (afër shkallëve), nuk ka pamje filmike të regjistruara për shkak të problemit hardware që kjo kamera ka.

Referuar procesverbalit të mbajtur gjatë takimit të datës 29.3.2023, punonjësja V. R. , deklaroi se është ofenduar nga ana e znj. B. e cila i është drejtuar me tone të larta dhe me fjalë ofenduese.

Znj. Gj, nga ana e saj deklaroi se, është njoftuar në lidhje me ngjarjen midis ankueses dhe punonjeses V. R. dhe faktin se ankuesja po i thoshte znj.R “inJORante, qelbësirë”. Znj. Gj. deklaroi se ka shkuar shpejt por jo duke bërëtitur. Ajo deklaroi se i ka thënë ankueses se për çdo problematikë duhet ti drejtohej asaj dhe se nuk kishte punë që tu bërtise. Znj. Gj deklaroi se znj. B. i është drejtuar me fjalët: “ *E di unë se çkam për tju bërë, do shkoni në gjyq thoshte, njëri do hiqet nga puna, mu afrome nxirrte gishtin u largonte thonte kush je ti më afrohej prapë.*” Kur erdhi juristja, znj. B. , e cila ka qenë duke u ngjitur vazhdonte të fyente, sipas znj. Gj. Znj. R. deklaroi gjatë takimit se është fyer me fjalë të rënda nga ana e znj. B. , dhe se këto fjalë paraprakisht i kishte thënë A. për pjesën e ofendimeve. Nga ana e znj. B, në takim deklarohet se, ka njoftuar rojen sepse ishte debati jashtë dhe po ta vazhdonin edhe pak do të ishte jashtë çdo norme. Ankuesja gjatë gjithë takimit, ka kundërshtuar pretendimet e ngritura ndaj saj si të pavërteta, duke pretenduar se të gjitha ishin shpifje.

Rezulton se, pamjet filmike të depozituara nga ana e TKOBAP, pasqyrojnë pamje të katit të tretë, sheshpushimi të shkallët nga krahu i hyrjes në zyrat e marketingut, të godinës së TKOBAP, për periudhën nga ora 20:00 deri në orën 21:00. Gjatë shqyrtimit nuk u administruan pamje filmike nga kati i parë, ku edhe ka filluar ngjarja, midis ankueses dhe punonjësës V. R. . Nga shqyrtimi i pamjeve filmike të depozituara nga ana e TKOBAP, rezulton se ato nuk kanë regjistrim audio dhe për rrjedhojë bisedat e zhvilluar midis personave që shfaqen në këto pamje nuk mund të dëgjohen. Në këto pamje, fillimisht shfaqet znj. B. duke ngjitur shkallët për të ndaluar më pas në shesh pushimin e katit, ku në shkallët që ngjitesh për në katin më sipër, gjendet të ulura dy punonjëset znj.R dhe znj.Y. Në pamje znj. B. shfaqet duke komunikuar me to. Më vonë shfaqet znj. B, me të cilën znj. B. komunikon, ndërsa më vonë shfaqet znj. Gj.

Vetë pala ankuese deklaroi në parashtrimet e depozituara në datën 15.12.2023, se ankuesja duket e revoltuar gjatë bisedës, por sipas saj kjo për shkak të ngjarjes së ndodhur në katin e parë, për të cilat nuk ka pamje filmike dhe se një gjë e tillë është krejtësisht normale për një person që sipas të gjitha ankesave të saj ndaj zyrës së marketingut është cenuar në të drejtën e saj si artiste. Pala ankuese, prapëson se, në asnjë moment nga pamjet filmike nuk rezulton që ankuesja t’i jetë afruar Anës në fytyrë, siç u pretendua gjatë seancës dëgjimore, duke u shitur si kërcënim.

Referuar procesverbalit të mbajtur nga znj. B në datën 24.2.2023, ajo deklaroi se kur ka takuar ankuesen në katin e tretë, kjo e fundit ishte duke ju bërëtitur vajzave për videon dhe se pas disa minutash kur znj. B. ka vazhduar të ofendojë vajzat dhe situata është agravuar, znj. B ka njoftuar rojen e institucionit për të qetësuar situatën deri sa palët kanë dalë jashtë institucionit.

Nga deklaratimet e palëve, por dhe aktet e administruara rezulton se, znj. A.Gj. dhe ankuesja, më pas janë paraqitur në Komisarjatin e Policisë Nr.1, Tiranë dhe kanë dhënë deklaratimet e tyre në lidhje me ngjarjen, ku rezulton të kenë qëndruar deri rreth orës 22: 00.

Në lidhje me momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ankuesja pretendon se zgjidhja e kontratës së punës është bërë në kundërshtim me Kodin e Punës, Kontratën Individuale të Punës, Kontratën Kolektive të Punës dhe Rregulloren e Institucionit. Pala ankuese pretendon se, punëdhënësi/TKOBAP ka bërë cilësim të gabuar juridik pasi nuk jemi në kushtet e rrethanave të rënda për të përligjur zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës.

Për të vlerësuar në lidhje me këto pretendime të palës ankuese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim rregullimet e mëposhte ligjore dhe nënlidhore:

Kodi i Punës

Neni 11

1. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:

- a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- b) Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë
- c) Ky Kod dhe aktet e tij nënligjore
- d) Kontrata kolektive e punës
- e) Kontrata individuale e punës
- f) Rregullorja e brendshme
- g) Zakonet lokale dhe profesionale

Neni 144

1. Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedojë me të.

2. Punëdhënësi, gjatë kësaj bisede, i parashtron punëmarrësit arsyet e vendimit të parashikuar për t'u marrë dhe i jep atij mundësi për t'u shprehur.

3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit. Në njoftimin me shkrim, punëdhënësi përcakton arsyet e zgjidhjes së kontratës, të cilat lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operacionale të ndërmarrjes.

4. Shfuqizuar.

5. Punëdhënësi, i cili nuk respekton procedurën e përcaktuar në këtë nen, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim të barabartë me pagën e dy muajve, që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera të mundshme.

5/1. I takon punëdhënësit të provojë respektimin e procedurës së përcaktuar në këtë nen.

.....

Neni 153

Shkaqe të justifikuara

1. Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.

2. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethA. t e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

3. Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.

Kontrata Kolektive e Punës datë 06.12.2007

Neni 14

Masat disiplinore

2. Për vlerësimin e shkeljeve të disiplinës në punë dhe përcaktimin e masës disiplinore palët mund të bien dakort për përcaktimin e një komisioni dypalësh.

Ky komision do të vlerësojë shkallëzimin e fajeve: faj i lehtë dhe faj i rëndë në bazë të të cilave do të vendosen sanksionet ndaj punëmarrësit

- Faj i rëndë konsiderohet, shkelje nga punëmarrësi të kontratës së punës.....

Në rastet e pushimit nga puna, punëdhënësi si rregull duhet të respektojë procedurën e njoftimit. megjithatë në rrethA. të pamundësisë së respektimit të procedurës nga punëdhënësi, ai mund të bëjë pushimin e menjëhershëm, duke shmangur procedurën.

Kontrata Kolektive e Punës datë 2.6.2020

Neni 11

Masat disiplinore

3. Në rast të shkeljes së disiplinës në punë, dëmtimit të rëndë ose të përsëritur të pasurisë së institucionit, punëmarrësve u jepen këto masa disiplinore:

- a. Vërejtje;
- b. Vërejtje me paralajmërim;
- c. Zbritje në detyrë për një vit;
- d. Dëmshpërblim i dëmit, deri në masën e dëmit të shkaktuar ose të vendosur nga gjykata;
- e. Largim nga puna;

4. Në rast të thyerjes së rëndë të etikës në punë dhe të sjelljeve të padenja nga punëmarrësi që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, vazhdimin e marrëdhënieve të punës, mund të bëhet zgjidhja e menjëhershme e kontratës individuale të punës, bazuar në nenin 153, të Kodit të Punës.

Neni 15

Procedura për zgjidhjen e kontratës së punës

1. Në rast mosmarrëveshje gjatë zbatimit të kësaj kontrate midis punëdhënësit dhe sindikatës bëhen përpjekje për t'i zgjidhur ato nëpërmjet bisedimeve dypalëshe. Në rast se konflikti nuk është zgjidhur, detyrimisht angazhohen instrumentet e ndërmjetësimit dhe të pajtimit.
2. Mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, realizohet sipas kreut XVII i Kodit të Punës.
3. Në rast se mosmarrëveshja nuk është zgjidhur me pajtim, palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Kontrata Individuale e Punës (Nr.225/2 prot datë 11.7.2020)

Neni 3

Të drejtat dhe detyrime të përgjithshme të punëmarrësit

5. Të zbatojë rregulloren e brendshme të institucionit, si dhe të mos silllet në kundërshtim me rregullat e etikës

Neni 4

Të drejtat dhe detyrime të vecanta të punëmarrësit

1. Punëmarrësi detyrohet të marrë pjesë në të gjitha shfaqet e repertorit të TKOBAP-së dhe pranë Sektorit të Solistëve sipas nevojës dhe udhëzimeve të Institucionit.

Neni 8

Shkeljet dhe masat disiplinore

Shkeljet e disiplinës në punë do vlerësohen me dy shkallëzime, shkelje të lehta dhe shkelje të rënda.

.....

b. Shkelje e rëndë konsiderohet:

- Shkeljet nga punëmarrësi të kontratës së punës

2. Në varësi të shkallëzimit të shkeljes së disiplinës, përcaktohet masa disiplinore.

.....

b. Për shkelje të rënda: vërejtje me shkrim, në raste të marrjes së dy vërejtjeve me shkrim brenda 6-muajve, pushim të menjëhershëm nga puna.

3. Punëdhënësi ka të drejtë të japë një masë disiplinore më të rëndë, edhe në rastin kur punëdhënësit nuk i janë dhënë masa disiplinore të tjera.

Rregullore e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor” (Nr.1850 prot datë 25.7.2014)

Neni 25

Disiplina dhe procedimi disiplinor

1.Masat disiplinore jepen nga titullari për thyerjen e disiplinës në punë dhe rregullave të etikës, si dhe cdo veprim ose mosveprim me faj i punonjësit, i cili bie ndesh meparashikimet e kësaj rregulloreje, kontratës individuale të punës, si dhe akteve nënligjore dhe nënligjore në fuqi.

.....

4.Konsiderohen shkelje të rënda:

.....

c.shkeljet nga punëmarrësi të kontratës së punës.

Bazuar në faktet dhe rrethanave të çështjes të cilat rezultuan të provuara, konstatohet se punëdhënësi ka respektuar procedurën për zgjidhjen e kontratës së punës, sipas nenit 144 të Kodit të Punës, duke e njoftuar ankuesen 72 orë para takimit të datës 29.3.2023. Në njoftimin për fillimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, rezulton që të jetë dhënë edhe motivacioni. Rezulton se ankuesja ka marrë pjesë në takimin e zhvilluar në datën 29.3.2023 së bashku me përfaqësuesin e saj ligjor, duke patur mundësinë për tu mbrojtur dhe për t'u dëgjuar. Në vijim të procedurës, konstatohet se vendimi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës i është komunikuar ankueses brenda afatit të përcaktuar nga neni 144 i K.Punës.

Ngritja e një komisioni dypalësh, parashikuar nga neni 14, i Kontratës Kolektive të datës 06.12.2007, për vlerësimin e shkeljeve të disiplinës në punë dhe përcaktimin e masës disiplinore, përbën një mundësi, në kushtet kur palët dakortësohen në lidhje me ndërmarrjen e këtij veprimi. Nuk rezulton nga aktet e konstatuara se para marrjes së vendimit për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies së punës në datën 04.04.2023, t'i jetë paraqitur punëdhënësit/TKOBAP ndonjë kërkesë nga Sindikata për ngritjen e një komisioni të tillë.

Sjellja në përputhje me rregullat e etikës, përbën një detyrim kontraktual, sipas kontratës individuale të punës të nënshkruar midis ankueses dhe TKOBAP. Sipas Kontratës Kolektive të Punës, Kontratës individuale të punës dhe Rregullores së Brendshme, shkelja e kontratës së punës nga punëmarrësi, konsiderohet shkelje e rëndë.

Referuar Kontratës Kolektive të Punës neni 11, pika 3, e cila ka përparësi referuar hierarkisë së normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet e punës, ndaj kontratës individuale të punës apo rregullores së brendshme, legjitimohet punëdhënësi që në rast të thyerjes së rëndë të etikës në punë që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, vazhdimin e marrëdhënieve të punës, mund të bëhet zgjidhja e menjëhershme e kontratës individuale të punës, bazuar në nenin 153, të Kodit të Punës.

Sipas nenit 153 të K.Punës, konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.

Në rastin objekt shqyrtimi nuk jemi në kushtet e shkeljes së detyrimeve kontraktuale me faj të lehtë në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit. Punëdhënësi/TKOBAP, ka vlerësuar se ankuesja ka shkelur detyrimet kontraktuale me faj të rëndë duke thyer rregullat e etikës, referuar ngjarjes së ndodhur më datë 24.02.2023 në ambientet e institucionit mes ankueses dhe punonjësve A.Gj. , me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe punonjësës V. R. , Specialiste pranë Sektorit të Promocionit dhe Imazhit, në kundërshtim të plotë me rregullat e etikës dhe komunikimit që kaloi në fyerje dhe dhunë verbale të ushtruar nga ana e ankueses ndaj punonjësve ndërkohë që po ushtronin detyrën e tyre funksionale në përcjelljen dhe promovimin e operetës “Karnavalet e Korçës”.

Komisioneri e gjen të pabazuar pretendimin a palës ankuese se zgjidhja e kontratës së punës është bërë në kundërshtim me nenin 181, pika 4 të Kodit të Punës, pasi nuk është marrë pëlqimi i Sindikatës për zgjidhjen e kontratës me ankuesen apo nuk është njoftuar Sindikata, si përfaqësuese e interesave të ankueses, si anëtare e saj.

Konkretisht në neni 181, pika 4 të Kodit të Punës parashikohet: *“4. Zgjidhja e kontratës së punës, nga punëdhënësi, për përfaqësuesit e organizatës sindikale, pa pëlqimin e kësaj organizate, është e pavlefshme...”*. Për sa kohë që ankuesja nuk është përfaqësuese e organizatës sindikale, por anëtare e saj, dispozita e sipërcituar nuk gjen zbatim, dhe në këto kushte TKOBAP, nuk ka patur detyrimin që të marrë pëlqimin e Sindikatës, anëtare e të cilës është ankuesja, para se të merrte vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës.

Në lidhje me pretendimet e palës ankuese se, nuk është respektuar neni 15, i Kontratës Kolektive të Punës, të vitit 2020, për shkak se TKOBAP, ka refuzuar propozimin për ndërmjetësim të problemit, Komisioneri konstaton se, dispozita e pretenduar e Kontratës Kolektive, rregullon mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis palëve nënshkruese të Kontratës Kolektive dhe nuk përmban parashikime për ndërmjetësimin e Sindikatës në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës me punëmarrësit.

Bazuar në tërësinë e provave të administruara, Komisioneri nuk konstaton veprime ose mosveprime të punëdhënësit/TKOBAP, të cilat e ekspozojnë ankuesen ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, në kuadër të procedurës së ndjekur për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës me ankuesen.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja znj. Sh.B (B) nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë, nga ana e Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansamblit Popullor. Në mungesë të

trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, kryesisht Komisioneri konstaton se, TKOBAP, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit dhe konkretisht, parashikimet e nenit 13, të LMD, ku parashikohet: “1.Punëdhënësi është i detyruar: a) t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre”, pasi në disa ankesa të depozituara nga ankuesja, ku nga ana e saj ngrihen problematikat e pretenduar prej saj në lidhje me punën, të cilat i cilëson si diskriminim ndaj saj, nuk kanë marrë një trajtim efektiv sipas dispozitës së mësipërme ligjore.

Nëpërmjet konstatimit të mësipërm, Komisioneri nuk ka vlerësuar bazueshmërinë e ankesave të paraqitura nga ankuesja pranë punëdhënësit, por çmon të evidentojë se, çdo punëdhënës, ka detyrimin sipas LMD, që në çdo rast të shqyrtojë në mënyrë efektive ankimet e marra ku pretendohet diskriminim.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses znj. Sh. B. (B), për shkaqet e pretenduara prej saj, nga ana e Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor.
2. Me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit, parashikuar ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri rekomandon Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, që të marrë masa për të përcaktuar në aktet e brendshme institucionale, mënyrën dhe procedurën e shqyrtimit të ankesave dhe pretendimeve për diskriminim, të cilat paraqiten nga punonjësit.
3. Në kuadër të detyrimeve si punëdhënës, që rrjedhin nga neni 13, pika 2, e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, rekomandohet që të marrë masa për të rritur ndërgjegjësimin për këtë ligj, duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës.
4. Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Çdo shkak tjetër
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim